



MIRATOI
KRYETARI I BASHKISË
Ilir XHAKOLLI



RAPORTI I PERFORMANCËS

2025



BASHKIA POGRADEC

Ky botim mbështetet nga 'Bashki të Forta', projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC dhe Qeverisë së Suedisë, i zbatuar nga Helvetas.

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e Qeverisë së Zvicrës apo të Suedisë.

Pogradec, 2026



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Sweden
Sverige



Përmbajtja

Fjalor Shpjegues	3
Qellimi i Raportit	6
Vështrim i Përgjithshëm mbi Bashkinë	8
Të Dhënat e Përgjithshme të Bashkisë	7
SHERBIME PUBLIKE VENDORE.....	8
📖 Arsimi Paraniversitar.....	8
🏠 Menaxhimi i Mbetjeve.....	11
🔥 Mbrojtja nga zjarri.....	14
💧 Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	16
🌳 Administrimi i pyjeve dhe kullotave.....	18
👥 Mbrojtja Sociale	20
QEVERISJA E MIRE	23
👥 Burimet Njerëzore	24
☐ Transparenca	27
👥 Barazia Gjinore.....	29
👥 eu Integrimi në BE.....	31
Menaxhimi financiar.....	34
🎯 Planifikimi strategjik.....	37
🏢 Shërbime publike.....	41
👥 Fusha e biznesit.....	53



FJALOR SHPJEGUES

Disagregim

Është procesi i ndarjes së të dhënave sipas kategorive të veçanta (si gjinia, mosha, vendbanimi urban/rural, tipi i institucionit publik/privat etj.) me qëllim që të kuptohet më mirë shpërndarja dhe ndikimi i një shërbimi ose fenomeni. Disagregimi ndihmon për të evidentuar pabarazitë, për të krahasuar grupet e ndryshme dhe për të planifikuar politika apo ndërhyrje më të drejtuara dhe gjithëpërfshirëse.

Funksion

Është fusha e veprimtarisë, për të cilën njësi e vetëqeverisjes vendore është përgjegjëse dhe ka kompetencën ligjore për ta ushtruar lirisht, tërësisht apo në një pjesë të tij, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore

Nën-Tregues

Një nën-tregues është një element më i detajuar i një treguesi kryesor, që shërben për ta shpërbërë dhe matur më saktësisht një aspekt të veçantë të tij. Nën-treguesit ndihmojnë në kuptimin më të thelluar të performancës, duke dhënë informacion të ndarë sipas gjinive, zonave gjeografike, llojit të shërbimit (publik/privat) apo kritereve të tjera të disagregimit.

Produkt

Një produkt i realizuar nga bashkia i referohet një të mirë materiale ose shërbimi që ofrohet nga bashkia, e cila është përgjegjëse për ofrimin e shërbimit apo të mirës materiale. Bashkitë sipas ligjit janë përgjegjëse për ofrimin e një game të gjerë shërbimesh publike, si transporti, kanalizimi, furnizimi me ujë, menaxhimi i mbetjeve, shërbimet e mbrojtjes nga zjarri dhe asaj civile etj.

Qeverisja e Mirë

I referohet parimeve dhe praktikave që garantojnë funksionimin efikas, transparent, gjithëpërfshirës dhe të drejtë të një bashkie. Në këtë kuadër përfshihen elementë si transparenca publike, barazia gjinore, integrimi në BE, pjesëmarrja qytetare, profesionalizmi i burimeve njerëzore dhe menaxhimi i qëndrueshëm financiar.

Sistemi i Matjes së Performancës

Është mekanizmi kombëtar dhe vendor për mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e të dhënave mbi ofrimin e shërbimeve nga bashkitë. Ky sistem përfshin një grup treguesish dhe nën-treguesish të standardizuar, që përdoren për të krahasuar performancën e bashkive, për të rritur transparencën, llogaridhënien dhe për të mbështetur vendimmarrjen e bazuar në evidencë. Bazuar në Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 33, çdo bashki është e detyruar të krijojë një sistem të brendshëm matjeje dhe raportimi mbi performancën e saj, në lidhje me ofrimin e shërbimeve publike, përdorimin e burimeve dhe realizimin e objektivave. Ky sistem vendor lidhet ngushtë me sistemin kombëtar, duke mundësuar harmonizimin e të dhënave dhe krahasimin mes njësisive të vetëqeverisjes vendore.



Sherbime Publike Vendore

Janë shërbimet që ofrohen nga bashkia për komunitetin, në përputhje me funksionet e përcaktuara nga ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore". Këto përfshijnë, ndër të tjera, ndriçimin publik, arsimin parashkollor dhe çerdhet, mbrojtjen sociale, menaxhimin e mbetjeve, pyjeve e kullotave dhe ujtitjen dhe kullimin etj. Sipas përkufizimit të ligjit "janë ato shërbime me interes të përgjithshëm publik, të cilat ofrohen për komunitetin nga bashkitë, në mënyrë të vazhdueshme, me çmime të përballueshme, sipas standardeve minimale kombëtare, të përcaktuara me ligj apo me akte të tjera normative"

Tregues performance

Një tregues i performancës është një matje që përdoret për të vlerësuar suksesin ose përparimin e një procesi. Mund të përdoret për të gjurmuar arritjet kryesore të performancës, të tilla si performanca financiare, kënaqësia e klientit, produktiviteti i punonjësve ose efikasiteti operacional, ose buxhetor / financiar dhe për të përcaktuar nëse synimet ose objektivat po përmbushen. Treguesit e performancës përdoren shpesh në sektorin privat por edhe atë publik dhe organizata të tjera për të ndihmuar menaxherët të marrin vendime të informuara, të identifikojnë fushat e përmirësimit dhe të masin performancën e përgjithshme të bashkisë.

Të Dhëna

Janë informacionet e mbledhura nga burime zyrtare të bashkisë ose institucione të tjera, që shërbejnë si bazë për llogaritjen e treguesve të performancës. Të dhënat mund të jenë numerike (statistika mbi popullsinë, buxhetin, shkollat etj.) ose cilësore (planifikime, raporte, dokumente strategjike) dhe janë të domosdoshme për analizën dhe raportimin e performancës.

Taksat e ndara

Janë taksa kombëtare që mbledhen nga qeveria qendrore dhe ndahen plotësisht ose pjesërisht me bashkitë

Taksat vendore Janë detyrime fiskale të bashkisë të cilat paguhet sipas parashikimeve ligjore dhe përcaktimeve të Këshillit Bashkiak

Tarifat vendore

Janë detyrime që individët apo bizneset paguajnë kundrejt marrjes së një shërbimi të ofruar nga bashkia

Transfertat e kushtëzuara

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë për t'u përdorur vetëm për projekte të veçanta apo funksione të deleguara të bashkisë

Transfertat e pakushtëzuara

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti shtetit) i jep bashkisë për t'u përdorur pa kushte, pa interes dhe pa të drejtë kthimi



Transferta e pakushtëzuar sektoriale

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë me kushtin për t'u përdorur vetëm për funksione specifike që bashkia i ka marrë nga Qeveria me ligj të veçantë

Trashëgimi nga viti i kaluar

Janë fonde buxhetore të bashkisë të cilat nuk janë shpenzuar në mbyllje të vitit buxhetor të kaluar dhe mund të përdoren në vitin korent buxhetor. Ato mund të jenë me destinacion dhe pa destinacion. Varësisht nga kjo ato mund të përdoren gjatë vitit korent me destinacion të përcaktuar (për ato projekte apo zëra buxhetor specifik për të cilat janë angazhuar gjatë vitit të kaluar por nuk kanë arritur të shpenzohen) apo pa destinacion (për çfarëdo zë apo projekt).

Si të lexojmë tabelën e performancës

Tabelat e treguesve në çdo fushë paraqesin ecurinë e treguesve të performancës për secilën fushë funksionale. Për çdo tregues jepen vlerat për dy vite, ndryshimi ndërvite, trendi, dhe semafori, të cilat ndihmojnë në interpretimin e rezultateve.

Kolona	Përshkrimi
Treguesi	Emri i treguesit që mat një aspekt të caktuar të performancës (p.sh. "Përqindja e konsultimeve publike të zhvilluara").
Njësia matëse	Tregon mënyrën se si matet treguesi (p.sh. %, numër, ha, lekë/frymë).
Vlera 2024 / 2025	Tregojnë rezultatet e arritura për secilin vit.
Ndryshimi (%)	Diferenca në përqindje ndërmjet viteve. Formula: $(\text{Vlera 2025} - \text{Vlera 2024}) / \text{Vlera 2024} \times 100$.
Trendi dhe Simboli i Trendit (→ ↑ ↓)	Diferenca në vlerë absolute ndërmjet viteve. $(\text{Vlera 2025} - \text{Vlera 2024})$. Simboli i Trendit tregon drejtimin e lëvizjes: ↑ përmirësim, ↓ përkeqësim, → stabilitet
Semafori	Vlerësim vizual i nivelit të performancës: ● = vlerë absolute ndryshimi pozitiv ● = vlerë absolute ndryshimi negative.

Nota metodologjike mbi semaforin dhe interpretimin e treguesve

Në tabelat e performancës, ngjyra e semaforit llogaritet automatikisht sipas parimit të përgjithshëm "vlera positive ndryshimi = jeshile". Kjo rregull zbatohet njëtrajtësisht për të gjithë treguesit dhe mund të japë vizualisht ngjyrë të kuqe edhe në raste kur rezultati real është pozitiv.



Në veçanti, për disa tregues me logjikë të përbysur, ulja e vlerës absolute përfaqëson përmirësim të performancës. Këtu përfshihen, ndër të tjera:

- Detyrimet e prapambetura (rënia tregon përmirësim financiar).
- Shpenzimet administrative (ulja tregon efikasitet).

QELIMI I RAPORTIT

Raporti i Performancës 2025 synon të ofrojë një pasqyrë të qartë dhe të strukturuar mbi performancën e bashkisë në 11 fusha funksionale. Ky raport përdoret për të ndihmuar vendimmarrjen e bazuar në të dhëna, për të forcuar transparencën dhe llogaridhënien, si dhe për të mundësuar krahasimin ndërmjet bashkive në nivel kombëtar. Ky raport është përgatitur nga Bashkia Pogradec, i mandatuar nga Kryetari i Bashkisë në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015, Neni 33, si dhe në kuadër të Sistemit Kombëtar të Matjes së Performancës (SMP 2025).

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI BASHKINË

Bashkia Pogradec e pozicionuar në juglindje të vendit përbëhet nga 8 Njësi Administrative: Pogradec, Bucimas, Cërravë, Dardhas, Trebinjë, Proptisht, Udënisht dhe Velcan me sipërfaqe prej 549 km². Popullsia e bashkisë numëron rreth 59 mijë banorë sipas formules së MFE : $census\ 2023 + [(numrin\ e\ popullsisë\ sipas\ gjendjes\ civile - nr.\ popullsisë\ sipas\ censusit\ 2023) * 0.3]$, dhe rreth 91 mijë banorë sipas gjendjes civile. Bashkia drejtohet në mandatin e dytë të tij nga Kryetari i zgjedhur Z. Ilir Xhakolli. Bashkia ka përgjegjësinë të ofrojë shërbime në përputhje me standardet kombëtare të miratuara. Bashkia Pogradec përfaqëson një nga zonat me potencialin më të lartë turistik, kulturor dhe natyror në Shqipëri. Falë pozicionit gjeografik, burimeve natyrore dhe trashëgimisë historike, ajo mbetet një qendër e rëndësishme zhvillimi në Juglindje të vendit. Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm, përmirësimi i infrastrukturës dhe mbrojtja e Liqenit të Ohrit janë drejtimet strategjike kryesore për të ardhmen.

TË DHËNAT E PËRGJITHSHME TË BASHKISË

E DHËNA	Viti 2025
Popullsia totale nën administrimin e bashkisë	59830
Sipërfaqja totale e bashkisë (në km ²)	549
Sipërfaqe publike e bashkisë në km ²	29
Sipërfaqja e njësive administrative në total	520



Sipërfaqe totale e fondit pyjor (në ha)	26369
Sipërfaqe totale e fondit kullosor (në ha)	22104
Sipërfaqja e tokës bujqësore (në ha)	16258
Numri total i njësive administrative të bashkisë	8
Numri i fshatrave	72
Punonjës të bashkisë në total	768
Numri total i punonjëseve femra të bashkisë	376
Numri total i punonjësve meshkuj të bashkisë	392
Numri total i punonjësve që punojnë për administratën e bashkisë	232

SHERBIME PUBLIKE VENDORE

Ky kapitull paraqet performancën e bashkisë në ofrimin e shërbimeve publike vendore, të cilat përbëjnë thelbin e përgjegjësisë të saj sipas Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore". Në këtë kuadër, janë trajtuar gjashtë fusha kryesore të aprovuara edhe në kuadër të raportit kombëtar të performancës bashkiake, që përfshijnë gjithsej 10 funksione: arsimit parauniversitar (ku hyjnë çerdhet, arsimit parashkollor dhe infrastruktura e godinave arsimore), ujitja dhe kullimi, administrimi i pyjeve dhe kullotave, menaxhimi i mbetjeve, mbrojtja nga zjarri, mbrojtja civile, si dhe mbrojtja sociale, e cila përfshin katër shërbime të detyrueshme sipas nenit 24 të ligjit. Matja e performancës në këto fusha bazohet në tregues të standardizuar sipas SMP Kombëtar, tregues të tjerë vendor që janë përzgjedhur nga bashkia, si dhe nën-tregues të detajuar, të cilët ofrojnë një pasqyrë të qartë mbi aksesin e qytetarëve në shërbime, cilësinë dhe kapacitetet e tyre, si dhe barazinë në ofrim ndërmjet grupeve të ndryshme shoqërore. Përmes këtij sistemi, bashkia ka mundësi të identifikojë përparimet e arritura, sfidat e mbetura dhe nevojat për përmirësim në ofrimin e shërbimeve themelore për komunitetin.



ARSIMI PARANIVERSITAR

Përshkrim i përgjithshëm: Arsimi parauniversitar në bashki përfshin shërbimet e arsimit parashkollor (çerdhe dhe kopshte), arsimin bazë 9-vjeçar dhe arsimin e mesëm të përgjithshëm. Kompetencat për administrimin dhe zhvillimin e këtij sektori janë të deleguara te njësitë e vetëqeverisjes vendore sipas Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

Dy funksionet kryesore që rregullojnë këtë fushë janë:

- Funksioni 23.11: "Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale."

_Funksioni 23.12: "Administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe." Në këtë kuadër, bashkia është përgjegjëse njëkohësisht për aspektet infrastrukturore dhe menaxheriale të institucioneve arsimore nën juridiksionin e tyre. Kjo përfshin ndërtimin dhe mirëmbajtjen e objekteve shkollore (23.11), si dhe administrimin e plotë të sistemit parashkollor (kopshte dhe çerdhe) përmes funksionit 23.12, që përfshin menaxhimin e stafit ndihmës, mbështetjen logjistike dhe rregullimin funksional të shërbimit.

TË DHËNAT E SHËRBIMIT

E dhëna	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
Numri i fëmijëve të moshës nga 6 muaj-3 vjeç në bashki	1110	918	Numër
Numri i fëmijëve të moshës 6 muaj deri në 3 vjeç të regjistruar në çerdhe publike	67	68	Numër
Numri i fëmijëve të moshës nga 3-6 vjeç në bashki	1620	1556	Numër
Numri i fëmijëve të moshës 3-6 vjeç që frekuentojnë kopshtet publike	1311	1222	Numër
Numri i fëmijëve të moshës 3-6 vjeç që frekuentojnë kopshtet private	191	164	Numër
Numri i edukatorëve në kopshte publike	142	142	Numër
Numri i edukatorëve në kopshte private	15	12	Numër
Numri i çerdheve publike në bashki	1	1	Numër
Numri i çerdheve private në bashki	0	0	Numër
Numri i kopshteve publike në bashki	44	44	Numër
Numri i kopshteve private në bashki	4	4	Numër
Numri i shkollave 9-vjeçare publike në bashki	25	25	Numër




Numri i shkollave 9-vjeçare private në bashki	3	3	Numër
Numri i shkollave të mesme të përgjithshme publike në bashki	10	10	Numër
Numri i shkollave të mesme të përgjithshme private në bashki	2	2	Numër
Plani vendor i Arsimit Parauniversitar, I miratuar ose zbatuar	1	1	Po/Jo

TREGUESIT E PERFORMANCËS

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2024	Vlera 2025	Trendi	Simbol	% Ndryshimi	Semaforimi
Tregues	Shkalla e regjistrimit në çerdhe publike	nxënës/mësues	6.04	7.41	1.37	↑	22.72%	●
Tregues	Shkalla e regjistrimit në kopshte publike dhe private	%	92.72	89.07	-3.64	↓	-3.93%	●
Tregues	Plani Vendor i Arsimit Parauniversitar	Po/Jo	0.00	1.00	1.00	→	100%	●
Tregues	Raporti fëmijë-mësues në kopshte publike dhe private	nxënës/mësues	1098.29	1113.62	15.33	↑	1.40%	●
Tregues	Godina Arsimore sipas nivelit arsimor	numër	89.00	89.00	0.00	→	0.00%	●
Nëntregues	Godina Arsimore publike sipas nivelit arsimor	numër	80.00	80.00	0.00	→	0.00%	●
Nëntregues	Godina Arsimore private sipas nivelit arsimor	numër	9.00	9.00	0.00	→	0.00%	●
Nëntregues	Raporti fëmijë-mësues në kopshte publike	nxënës/mësues	9.23	8.61	-0.63	↓	-6.79%	●
Nëntregues	Raporti fëmijë-mësues në kopshte private	nxënës/mësues	15.92	13.67	-2.25	↓	-14.14%	●

Shkalla e regjistrimit dhe raporti fëmijë-mësues në kopshte publike e private 2024-2025




Analiza e Shërbimit

Për vitin 2025, Bashkia Pogradec, ruajti mbulim 100% të fëmijëve në arsimin parashkollor, duke treguar stabilitet të arsimit dhe funksionim të qëndrueshëm të shërbimit. Një nga zhvillimet më pozitive është rritja e shkallës së regjistrimit në çerdhe publike, e cila ka kaluar nga 6.04 në 7.41, me një rritje prej 22.72%. Ky është një tregues i rëndësishëm që sinjalizon rritje të interesit për shërbimet e kujdesit për fëmijët e vegjël. Megjithatë, vihet re një rënie në shkallën e regjistrimit në kopshte (publike dhe private), e cila ka zbritur nga 92.72% në 89.07%, duke shënuar një rënie prej -3.93%. Kjo tregon se një pjesë e fëmijëve të moshës parashkollore nuk po frekuentojnë kopshtet, çka mund të lidhet me faktorë si emigracioni, ulja e lindshmërisë apo vështirësi ekonomike të familjeve. Nga analiza e të dhënave të shërbimit konstatohet një rënie e vazhdueshme e numrit të fëmijëve në grupmoshat kryesore. Numri i fëmijëve 3-6 vjeç në bashki ka rënë nga 1660 në 1556, ndërsa numri i atyre që frekuentojnë kopshtet publike ka rënë nga 1412 në 1222. Kjo përforcon idenë se rënia e regjistrimeve lidhet edhe me tkurrjen demografike. Raporti fëmijë-mësues në total (publik + privat), është rritur lehtë (nga 1098.29 në 1113.62), duke treguar një ngarkesë pak më të lartë për edukatorët. Ndërkohë, në mënyrë më specifike, raporti në kopshtet publike është përmirësuar (nga 9.23 në 8.61), çka do të thotë më pak fëmijë për edukator dhe potencialisht cilësi më e mirë. Në kopshtet private gjithashtu ka përmirësim (nga 15.92 në 13.67), por ende mbetet më i lartë se në sektorin publik. Një tjetër element i rëndësishëm është infrastruktura arsimore, e cila rezulton stabile. Nga të dhënat, vihet re se numri i kopshteve publike ka rënë nga 49 në 44, ndërsa institucionet e tjera arsimore (shkollat 9-vjeçare dhe të mesme) kanë mbetur konstante. Kjo sugjeron një konsolidim të rrjetit arsimor, ndoshta si pasojë e uljes së numrit të nxënësve. Në aspektin strategjik, është pozitiv fakti që Plani Vendor i Arsimit Parauniversitar rezulton i miratuar dhe në zbatim çka tregon ekzistencën e një kuadri planifikues.

Në përfundim, sistemi arsimor në bashki paraqet një situatë stabel: nga njëra anë ka përmirësime në aksesin në çerdhe dhe në raportet fëmijë-edukator në disa segmente, ndërsa nga ana tjetër përballlet me rënie të numrit të fëmijëve dhe ulje të regjistrimeve në kopshte. Këto zhvillime kërkojnë politika më aktive për të adresuar sfidat demografike, për të rritur përfshirjen në arsimin parashkollor dhe për të optimizuar përdorimin e burimeve ekzistuese.

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Fusha	Sfida kryesore	Artritjet 2025	Objektivat 2026
 Arsimi Parauniversitar	-Ulje e regjistrimit të fëmijëve në kopshte publike dhe private. -Nevoja për rehabilitim dhe mirëmbajtje të vazhdueshme të godinave arsimore.	-Hartimi dhe miratimi i planit vendor. -Rritje e regjistrimit në çerdhe (6.04%→7.41%) -Stabilitet në raportin fëmijë -mësues.	-Zbatim dhe monitorim sistematik i Planit të Arsimit Parauniversitar -Përmirësim i regjistrimit të fëmijëve në kopshte publike dhe private -Mirëmbajtje të vazhdueshme të godinave arsimore.



MENAXHIMI I MBETJEVE

Përshkrim i përgjithshëm: Bashkia është përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve urbane dhe mbrojtjen e mjedisit në territorin e saj. Ky funksion përfshin të gjitha aspektet që lidhen me mbledhjen, largimin, transportin, trajtimin dhe depozitimin e mbetjeve, si dhe mirëmbajtjen e pastërtisë në hapësirat publike si rrugët, sheshet, tregjet dhe parqet. Nëpërmjet këtij funksioni, bashkia siguron krijimin dhe operimin e sistemeve vendore për menaxhimin e mbetjeve, duke përfshirë strukturat teknike, logjistikën, kontraktimin e subjekteve private dhe kontrollin e zbatimit të standardeve mjedisore. Shembuj të aktiviteteve përfshijnë: Mblidhjen dhe funksionimin e sistemeve për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve; Pastrimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike (rrugë, parqe, tregje, kopshte publike); Dhënie të granteve ose fondeve për investime në infrastrukturën e mbetjeve; Monitorimin e ndotjes dhe koordinimin me institucionet për mbrojtjen e mjedisit. Ky funksion rrjedh nga Ligji Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 23, i cili i nje bashkise kompetencën për menaxhimin e shërbimeve publike vendore, përfshirë menaxhimin e mbetjeve urbane dhe mirëmbajtjen e pastërtisë publike.



TË DHËNAT E SHËRBIMIT

E dhëna	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
Numri njësive administrative qendër (qytete) të mbuluar me shërbimin e mbetjeve	8	8	Numër
Numri njësive administrative qendër (qytete) të bashkisë	8	8	Numër
Numri fshtrave të mbuluar me shërbimin e mbetjeve	52	52	Numër
Numri fshatrave në territorin e bashkisë	72	72	Numër
Sasia e mbetjeve të gjeneruara gjithsej	13019000	13872000	Kg
Të ardhurat gjithsej nga tarifa e shërbimit të mbetjeve	111630	116103	mijë Lekë
Shpenzime gjithsej për ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve	144595	142874	mijë Lekë
Plani i miratuar ose zbatuar gjatë vitit të raportimit	0	0	Cilësore (Po/Jo)
Popullsia e përgjithshme e bashkisë	59834	59830	Numër

TREGUESIT E PERFORMANCËS

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2024	Vlera 2025	Trendi	Simbol	% Ndryshimi	Semafor
Tregues	Mbulimi i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në zonat urbane/rurale	%	86.11	86.11	0.00	→	0.00%	●
Tregues	Mbetjet e gjeneruara si kg/banor	kg/banor	217.59	231.86	14.27	↑	6.56%	●
Tregues	Mbulimi i kostos së menaxhimit të mbetjeve nga tarifa e shërbimit	%	77.20	81.26	4.06	↑	5.26%	●
Tregues	Plani vendor i menaxhimit të mbetjeve i miratuar ose në zbatim	Numër	0.00	0.00	0.00	→	0.00%	●
Nen-tregues	Mbulimi i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në zonat urbane	%	100.00	100.00	0.00	→	0.00%	●
Nen-tregues	Mbulimi i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve tregues në zonat rurale	%	72.22	72.22	0.00	→	0.00%	●



Mbulimi i popullsisë dhe i kostos nga tarifa e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve 2024-2025



Analiza e Shërbimit Shërbimi për menaxhimin e mbetjeve për vitin 2025 ka qënë në nivel të qëndrueshëm me përmirësime të pjesshme, kryesisht në aspektin financiar dhe në sasinë e mbetjeve, ndërsa mbulimi mbetet i pa ndryshuar. Mbetjet e gjeneruara për banor janë rritur me (+6.56%) kjo tregon një rritje të konsumit, ose përmirësim në mbledhjen dhe raportimin e mbetjeve. Mbulimi i kostos së menaxhimit të mbetjeve nga tarifa e shërbimit ka patur një rritje me (+5.26%) gjë që tregon se tarifa e shërbimit ka mbuluar me shumë shpenzime dhe tregon një qëndrueshmëri financiare të shërbimit. Mbulimi i popullsisë me këtë shërbim në nivel bashkie është 86%. Për zonën urbane ky shërbim mbulon 100%, dhe në zonat rurale mbulon 72%. Në të dy vitet e vlerësuara, bashkia nuk ka pasur plan vendor për mbetjet, çka kufizon aftësinë për të orientuar zhvillimin e sektorit në mënyrë të strukturuar. Mungesa e këtij dokumenti strategjik tregon për mbetjet, se ende nuk ka një vizion të qartë për zhvillim në përputhje me standardet kombëtare apo ato të BE-së.

Përfundime: Në përgjithësi, bashkia ka ruajtur stabilitet në ofrimin e shërbimit të mbetjeve. Sfidat mbetet hartimi dhe miratimi i planit vendor të mbetjeve, si dhe sigurimi i mbulimit të plotë të popullsisë në të gjithë fshatrat me shërbimin e mbetjeve.

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Fusha	Sfida kryesore	Arritjet 2025	Objektivat 2026
Menaxhimi i Mbetjeve	-Mungesa e planit vendor për menaxhimin e mbetjeve. -Mbulim i pjesshëm me shërbimin e mbetjeve i zonave rurale (72%)	-Mbulim 100% me shërbimin e mbetjeve në zonat urbane. -Rritje e mbulimit të kostos së shërbimit (77%→81%)nga tarifa e shërbimit - Rritje e sasisë së mbetjeve të menaxhuara.	-Hartimi dhe miratimi urgjent i planit vendor për menaxhimin e mbetjeve. -Rritja e mbulimit në 100% në zonat rurale me shërbimin e mbetjeve. -Përmirësim i sistemit të tarifimit për mbulim 100% të kostos.



MBROJTJA NGA ZJARRI

Përshkrim i përgjithshëm: Bashkia ka përgjegjësi për garantimin e shërbimit zjarrëfikës në nivel vendor dhe për administrimin e strukturave përkatëse të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit. Ky funksion synon të sigurojë reagim të shpejtë dhe efektiv në raste emergjencash, si dhe të ndërtojë kapacitete vendore për parandalimin e zjarreve në mjedise urbane, rurale dhe pyjore. Përgjegjësitë e bashkise përfshijnë operimin dhe mirëmbajtjen e njësive zjarrëfikëse, organizimin e shërbimeve parandaluese, si dhe bashkëpunimin me strukturat qendrore për raste që tejkalojnë kapacitetet vendore. Bashkia gjithashtu angazhohet në edukimin e komunitetit dhe trajnimin e stafit për reagim dhe menaxhim të rreziqeve nga zjarret. Aktivitete përfaqësuese përfshijnë : - Funksionimi dhe pajisja e njësive zjarrëfikëse dhe shërbimeve të emergjencës;- Zbatimi i masave të parandalimit në ndërtesa publike dhe hapësira komunitare; -Trajnimi i stafit vendor dhe vullnetarëve për ndërhyrje dhe evakuim; -Mbështetja e fushatave sensibilizuese për komunitetin në lidhje me rreziqet nga zjarri.


TREGUESIT E PERFORMANCËS

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2024	Vlera 2025	Trendi	Simbol	% Ndryshimi	Semafor
Tregues	Zjarrëfikës për 1,500 banorë	punonjës/1500 banorë	0.69	0.72	0.02	↑	3.57%	●
Tregues	Automjete zjarrëfikëse për 10,000 banorë	mjete/10000 banorë	1.32	1.48	0.16	↑	12.50%	●

TË DHËNAT E SHËRBIMEVE

E dhëna	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
Numri i punonjësve zjarrëfikës në bashki	18.00	18.00	Numër
Popullsia e përgjithshme e bashkisë	59834	59830	Numër
Numri i mjeteve zjarrëfikëse funksionale në bashki	4,00	4,00	Numër

Automjete per 10000 banore dhe zjarrfikese per 1500 banore per vitin 2024-2025



Analiza e Shërbimit Analiza e treguesve të performancës për shërbimin zjarrfikës tregon një përmirësim të dukshëm në pamje të parë, pasi të dy treguesit kryesorë paraqesin rritje pozitive krahasuar me vitin e kaluar. Konkretisht, treguesi "Zjarrfikës për 1,500 banorë" është rritur nga 0.69 në 0.72, duke reflektuar një ndryshim prej 3.57%, ndërsa treguesi "Automjete zjarrfikëse për 10,000 banorë" është rritur nga 1.32 në 1.48, me një rritje prej 12.50%. Këto rezultate shoqërohen me trend pozitiv dhe sinjalizohen me indikatorë të gjelbër, duke sugjeruar një performancë në përmirësim. Megjithatë, një analizë më e thelluar e të dhënave burimore tregon se ky përmirësim nuk vjen si rezultat i rritjes së kapaciteteve reale të shërbimit, por kryesisht si pasojë e ndryshimeve demografike. Numri i punonjësve zjarrfikës ka mbetur konstant në 18 gjatë viteve të analizuara, ndërkohë që numri i mjeteve zjarrfikëse funksionale gjithashtu nuk ka pësuar ndryshim, duke mbetur në 4. Në të kundërt, popullsia e bashkisë ka pësuar një rënie e cila ka ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e vlerave relative të treguesve pasi bashkia nuk ka shtuar as staf të ri dhe as mjete shtesë për të përballuar emergjencat, duke mbetur në të njëjtin nivel operacional si më parë. Në përfundim, megjithëse treguesit paraqiten pozitivë në raportim, ata nuk reflektojnë një rritje të mirëfilltë të performancës apo të investimeve në shërbimin zjarrfikës. Objektiv për vitin 2026 mbetet ruajtja e mjeteve në gjendje të mirë funksionale, kjo mbështet reagimin efektiv ndaj emergjencave. Zhvillimi i aktiviteteve të edukimit komunitar për parandalimin e zjarreve. Bashkëpunimi me Agjencinë e Mbrojtjes Civile, Policinë Bashkiake dhe njësitë administrative mbetet thelbësor për zbatimin e Planit Vendor të Mbrojtjes Civile.



PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Fusha	Sfida kryesore	Arritjet 2025	Objektivat 2026
 Mbrojtja nga Zjarri	-Pajisje të kufizuara logjistike dhe mungesë trajnimesh periodike. -Menaxhimi i zjarreve duhet të kordinohet me strukturat qendrore, duke kërkuar bashkëpunim ndërinstytucional.	-Gadishmëri e vazhdueshme operacionale. -Mbulim i qëndrueshëm me punonjes, dhe ruajtje e numrit makinave ekzistuese. -Ruajtje e kapaciteteve operacionale të shërbimit zjarrfikës në të gjithë territorin e bashkisë.	-Trajnimi i punonjesve të shërbimit zjarrfikës, në përputhje me riskun territorial - Përmirësim i pajisjeve dhe zhvillim trajnimesh. -Zhvillimi i aktiviteteve të edukimit komunitar për parandalimin e zjarreve për reagim emergjent.

MENAXHIMI I INFRASTRUKTURËS SË UJITJES DHE KULLIMIT


Përshkrim i përgjithshëm: Funkzioni për mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit është pjesë e kompetencave të deleguara të NJVV-të sipas Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", konkretisht nëni 27 pika 1. Ky funksion përfshin ndërtimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të ujitjes dhe kullimit në territorin e bashkisë, si dhe përgatitjen e planeve vendore për menaxhimin e qëndrueshëm të rrjeteve përkatëse. Qëllimi i këtij funksioni është mbështetja e zhvillimit të qëndrueshëm të prodhimit bujqësor dhe mbrojtja e konsumatorëve përmes garantimit të furnizimit me ujë për vaditje dhe menaxhimin të ujërave të tepërta në zonat bujqësore.

TREGUESIT E PERFORMANCËS

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2024	Vlera 2025	Trendi	Simbol	% Ndryshimi	Semafor
Tregues	Tokë bujqësore e pajisur me kanale ujitje/kullimi	%	46.16	46.16	0.00	→	0.00%	
Tregues	Përqindja e kanaleve ujitëse dhe kulluese funksionale	%	35.56	38.59	3.04	↑	8.54%	
Nën-tregues	Përqindja e kanaleve ujitëse funksionale	%	34.40	36.80	2.40	↑	6.98%	
Nën-tregues	Përqindja e kanaleve kulluese funksionale	%	36.71	40.38	3.67	↑	10.00%	

TË DHËNAT E SHËRBIMEVE

E dhëna	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
Sipërfaqja gjithsej e tokës bujqësore në bashki	16258	16258	Hektarë
Sipërfaqja e tokës bujqësore e mbuluar me kanale ujitje dhe/ose kullimi	7505	7505	Hektarë
Gjatësia e kanaleve ujitëse	125	125	Kilometër (km)
Gjatësia e kanaleve ujitëse funksionale	43	46	Kilometër (km)
Gjatësia e kanaleve kulluese	136.2	136.2	Kilometër (km)
Gjatësia e kanaleve kulluese funksionale	50	55	Kilometër (km)




Analiza e Shërbimit

Në vitin 2025, bashkia ka ruajtur një nivel të qëndrueshëm të ofrimit të shërbimit të ujitjes dhe kullimit . Ka patur rritje të kanaleve kulluese funksionale me 40.38% krahasuar me vitin e kaluar që ishte 36.71% me një rritje prej 3.67%. Përmirësim ka patur dhe në kanalet ujites funksionale për vitin 2025 ka patur një rritje prej 36.80% nga 34.40% që ishte në vitin 2024 me një rritje prej 2.4%. Këto përmirësime reflektojnë investime në pastrimin dhe rehabilitimin e kanaleve, si dhe rëndësinë e mirëmbajtjes për mbrojtjen e tokës bujqësore nga përmbytjet dhe degradimi. Nuk ka patur ndryshim në sipërfaqen e tokës të mbuluar me kanale ujitje dhe kullimi .

Perfundime: Gjate vitit 2026 bashkia duhet të hartojë një plan për menaxhimin dhe rikonstruksionin e kanaleve kulluese dhe ujites prioritare .Zgjerimi gradual i mbulimit të tokës bujqësore me rrjete ujitjeje dhe kullimi, në përputhje me prioritetet bujqësore të territorit.



PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Fusha	Sfida kryesore	Arritjet 2025	Objektivat 2026
 Ujitja dhe Kullimi	-Mbulim i ulet i të tokës bujqësore me kanale ujitjeje dhe kullimi. -Nevojë për mirëmbajtje të vazhdueshme të kanaleve për të garantuar funksionalitet afatgjatë të rrjetit ekzistues.	-Rritje e ndjeshme e funksionalitetit të kanaleve ujitëse dhe kulluese . -Ruajtje e mbulimit të tokës bujqësore me rrjet ujitje/kullimi në nivel të qëndrueshëm (46.16%).	-Hartimi i planit të menaxhimit dhe rikonstrukcion i kanaleve prioritare . -Zgjerimi gradual i mbulimit të tokës bujqësore me rrjete ujitjeje dhe kullimi, në përputhje me prioritetet bujqësore të territorit.



ADMINISTRIMI I PYJEVE DHE KULLOTAVE

Përshkrim i përgjithshëm : Funkzioni i menaxhimit të pyjeve dhe kullotave, sipas nenit 27, pika 5 të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i është deleguar bashkise me qëllim administrimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të fondit pyjor dhe kullor publik që ndodhet brenda territorit të NJVV-ve. Bashkia është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e planeve të mbarështimit për fondet, monitorimin e tyre dhe për sigurimin e mbrojtjes kundër dëmtimeve, ndotjes apo zjarreve, në përputhje me legjislacionin për pyjet dhe kullotat.

TREGUESIT E PERFORMANCËS

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2024	Vlera 2025	Trendi	Simbol	% Ndryshimi	Semafor
Tregues	Plan Vendor Mbarështimi I miratuar ose zbatuar	Cilësori e (Po/Jo)	1.00	1.00	0.00	→	0.00%	●
Tregues	Shkalla e pajisjes me plane mbarështimi	%	39.42	50.08	10.66	↑	27.04%	●
Tregues	Punonjës për 1,000 hektarë	punonjës/1000 ha	1.10	1.14	0.04	↑	3.45%	●




Tregues	Mbulimi i shpenzimeve te sherbimit te menaxhimit te pyje dhe kullotave nga te ardhurat	%	0.34	0.53	0.19	↑	55.10%	
Tregues	Te ardhura te realizuara perkundrejt te ardhurave te planifikuara nga bashkia per te gjitha ekonomite pyjore gjate vitit	%	0.72	0.86	0.14	↑	19.28%	

TË DHËNAT E SHËRBIMIT

E dhëna	Vlera 2024	Vlera 2025	Njesia matese
Plan Vendor Mbarështimi I miratuar ose zbatuar	1.00	1.00	Cilësore (Po=1/Jo=0)
Sipërfaqja gjithsej e fondit pyjor dhe kullosor në bashki	26369.00	26369.00	Hektarë
Sipërfaqja e fondit pyjor dhe kullosor e mbuluar me plan mbarështimi	10394.97	13205.80	Hektarë
Numri i punonjësve për menaxhimin e fondit pyjor dhe kullosor	29.00	30.00	Numër
Te ardhurat nga pyjet dhe kullotat nga te gjitha ekonomite pyjore, fakt	7236.00	8631.00	Mije Leke
Shpenzimet per pyjet dhe kullotat	21000.00	16150.00	Mije Leke
Te ardhurat e planifikuara nga pyjet dhe kullotat nga te gjitha ekonomite pyjore	10000.00	10000.00	Mije Leke

Shkalla e pajisjes me plane mbarështimi , viti 2024-2025



SHKALLA E PAJISJES ME PLANE MBARËSHTIMI

Analiza e Shërbimit

Bashkia Pogradec administron një sipërfaqe të konsiderueshme të fondit pyjor e kullësor, për të cilën ka miratuar plane mbarështimi në përputhje me legjislacionin kombëtar. Gjatë vitit 2025, performanca në këtë sektor paraqitet e qëndrueshme, shkalla e pajisjes me plane të miratuara mbetet e lartë nga 39.42% në 50.08%, duke siguruar menaxhim afatgjatë e të qëndrueshëm të resurseve natyrore. Numri i punonjësve për 1,000 ha është i përafëruar me standardin minimal kombëtar, çka garanton mbulim efektiv të territorit pyjor. Siperfaqja e mbuluar me plan mbarështimi është rritur ndjeshëm për vitin 2025. Është miratuar një plan mbarështimi për dy ekonomi pyjore. Kjo tregon një fokus në planifikimin strategjik të bashkisë në lidhje me këtë shërbim. Sfidat kryesore mbetet forcimi i kapaciteteve teknike për monitorim dhe parandalim të zjarreve, si dhe sigurimi i fondeve për mirëmbajtje aktive të infrastrukturës së pyjeve dhe kullotave. Mbulimi i shpenzimeve të shërbimit të menaxhimit të pyjeve dhe kullotave nga të ardhurat ka pësuar një rritje me (0.19%)kjo tregon se është bere menaxhim shume l mire te ardhurave.

Përfundime: Gjatë vitit në vazhdim bashkia duhet të rrite kapacitetet për mbrojtjen nga zjarret dhe hartimin e planeve të reja të mbarështimit të pyjeve. Duhet të behet përditësim i inventarit fizik dhe teknik të fondit pyjor dhe kullësor dhe forcim i mbikëqyrjes në terren.

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Fusha	Sfidat	Arritjet 2025	Objektivat 2026
 Pyjet dhe Kullotat	<ul style="list-style-type: none"> -Nevoja për ndërhyrje më të gjerë në rigjenerimin pyjor, rehabilitimin e kullotave dhe masat parandaluese. -Sigurimi i fondeve për mirëmbajtje aktive të infrastrukturës së pyjeve dhe kullotave si dhe parandalimi i zjarreve. 	<ul style="list-style-type: none"> -Ruajtje e nivelit të mbulimit të fondit pyjor dhe kullësor me plane mbarështimi. -Zbatim i vazhdueshëm i Planit Vendor të Mbarështimit për të tretin vit radhazi. 	<ul style="list-style-type: none"> -Forcim i kapaciteteve për mbrojtjen nga zjarret dhe hartimi i planeve të reja të mbarështimit të pyjeve. -Përditësim i inventarit të fondit pyjor dhe kullësor dhe forcim i mbikëqyrjes në terren..



MBROJTJA SOCIALE

Përshkrim i përgjithshëm: Bashkia është përgjegjëse për krijimin, administrimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale vendore për individët dhe familjet në nevojë, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara, fëmijët pa përkujdesje prindërore, të moshuarit, viktimat e dhunës dhe trafikimit, si dhe grupet e tjera vulnerabël. Shërbimet përfshijnë ndihma financiare dhe në natyrë, mbështetje për strehim dhe përfshirje sociale, si dhe funksionimin e qendrave ditore apo rezidenciale. Qëllimi i tyre është të lehtësojnë jetesën dhe të nxisin integrimin e qytetarëve në komunitet. Ndër shërbimet kryesore përfshihen: pagesat për kujdestari dhe lindje, ndihma për energji dhe nevoja bazë, shërbime për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara, mbështetje në kushte emergjente, strehim të përkohshëm dhe përkujdesje në shtëpi, si dhe masa për riintegrimin e të papunëve në tregun e punës. Bashkia gjithashtu bashkëpunon me Organizata jo Fitimprurëse (OJF) dhe sektorin privat për ofrimin e këtyre shërbimeve në territor.



TREGUESIT E PERFORMANCËS

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2024	Vlera 2025	Tren di	Si mbol	% Ndryshi	Se maf or
Tregues	Përqindja e familjeve që marrin ndihmë ekonomike	%	96.22	95.41	-0.81	↓	-0.84%	●
Tregues	Shkalla e miratimit të strehimit social	%	19.47	15.56	-3.91	↓	-20.10%	●
Tregues	Numri i qendrave sociale komunitare publike, te licensuara për 10,000 banorë	qendra/10,000 banore	0.84	0.84	0.00	↑	0.01%	●
Tregues	Përqindja e rasteve të referuara nga mekanizmi i koordinuar i referimit (mkr) që përfitojnë shërbime sociale	%	91.23	100.00	8.77	↑	9.62%	●
Tregues	Përqindja e personave me aftësi të kufizuar, të referuar nga komisionet bio-psiko-sociale që marrin mbështetje sociale të integruara	%	17.89	34.00	16.11	↑	90.01%	●
Tregues	Plan vendor social	Cilësor e (Po/Jo)	1.00	1.00	0.00	→	0.00%	●
Nëntregues	Përqindja e personave grupmosha 18+ vjeç me aftësi të kufizuar, të referuar nga komisionet bio-psiko-sociale që marrin mbështetje sociale të integruara	%	20.18	36.96	16.78	↑	83.14%	●



TË DHËNAT E SHËRBIMIT

E dhëna	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
Numri i familjeve që kanë aplikuar për ndihmë ekonomike	3252	2810	Numër
Numri i familjeve përfituese të ndihmës ekonomike	3129	2681	Numër
Popullsia e përgjithshme e bashkisë	59834	59830	Numër
Numri i personave që kanë paraqitur kërkesë për strehim social	113	135	Numër
Numri i personave përfitues të strehimit social	22	21	Numër
Numri i qendrave sociale ditore funksionale	4	4	Numër
Numri i qendrave sociale rezidenciale funksionale	1	1	Numër
Numri i rasteve të dhunës në familje dhe formave të tjera të dhunës të referuara nga Mekanizmit i Koordinuar i Referimit	57	62	Numër
Numri i rasteve të dhunës në familje dhe formave të tjera të dhunës të referuara nga antarët e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit (MKR), të cilat kanë përfituar shërbime sociale	52	62	Numër
Numri i PAK të referuar nga shërbimet bio-psiko-sociale për të marrë shërbime sociale	788	200	Numër
Numri i PAK që marrin mbështetje si pasojë e referimit	141	68	Numër
Plani Vendor Social, i miratuar apo zbatuargjatë periudhës së raportimit	1	1	Citesore(Po=1/Jo=0)



Analiza e Shërbimit

Gjatë vitit 2025, Bashkia Pogradec ka përmirësime shumë të forta në ofrimin e shërbimeve sociale dhe mbështetjen për grupet te ndryshme ne nevojë. Por ka rënie në disa tregues kyç, sidomos në ndihmën ekonomike dhe strehimin social. Personat që kanë përfituar ndihmë ekonomike kanë pesuar një ulje të lehte me (-0.81% kjo tregon është e qe ulur varfëria ose janë rritur kërkesat për te përfituar ndihme ekonomike, por ulje e lehte është vërejtur dhe tek numri i përfituesve për strehim social (-3.91%). Numri i qendrave sociale për 10,000 banorë nuk ka patur ndryshim nga viti i kaluar. Mbulim 100% i rasteve të referuara nga mekanizmi i koordinuar i referimit (mkr) që përfitojnë shërbime sociale kjo është një arritje shumë e mirë institucionale. Kemi rritje me(16.11%) te personave me aftësi të kufizuar, të referuar nga komisionet bio-psiko-sociale që marrin mbështetje sociale të integruara, çka tregon se kemi forcim të bashkëpunimit ndër-institucional dhe ndjekje më të afërt të rasteve.


Perfundime: Performanca e përgjithshme e këtij shërbimi mbetet pozitive, në qëndrueshmërinë e mbulimit dhe menaxhimin e rasteve dhe shërbimeve sociale. Por dobësi strukturore ka në mbështetjen ekonomike dhe strehim. Ne vitin në vazhdim duhet te zgjerojme rrjetin e shërbimeve komunitare, për të përballuar kërkesa më të specializuara, veçanërisht për fëmijët, personat me aftësi të kufizuar dhe familjet në nevojë.


PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Fusha	Sfida kryesore	Arritjet 2025	Objektivat 2026
Shërbime sociale	<ul style="list-style-type: none"> -Rënie në përfshirjen në ndihmë ekonomike -Kapacitete të kufizuara në strehim social -Mungesë zgjerimi të shërbimeve (qendra sociale) -Ulje e numrit të referimeve për PAK (edhe pse performanca relative është rritur) 	<ul style="list-style-type: none"> -Zbatim i plotë i Planit Vendor Social dhe funksionim i MKR me mbulim 100% të rasteve. -Rritje në përqindje e rasteve të referuara nga MKR që përfitojnë shërbime sociale dhe e personave grupmosha 18+ vjeç me aftësi të kufizuar, të referuar nga komisionet bio-psiko-sociale që marrin mbështetje sociale të integruara. 	<ul style="list-style-type: none"> -Rishikim i skemës së ndihmës ekonomike (akses + kritere) -Rritje e transparencës në përzgjedhjen për strehim social. -Shtim i fondeve për strehim social -Zgjerim i qendrave sociale në raport me popullsinë. - Fokus te parandalimi (jo vetëm trajtimi i rasteve) -Integrim më i fortë i shërbimeve sociale me ato shëndetësore dhe arsimor

QEVERISJA E MIRE

Qeverisja e mirë përfaqëson aftësinë institucionale të bashkisë për të ushtruar përgjegjësitë publike me integritet, transparencë dhe efikasitet, duke garantuar përfshirjen qytetare dhe barazinë e mundësive. Në kuadër të matjes së performancës vendore, qeverisja e mirë vlerësohet përmes katër fushave përfaqësuese, të cilat reflektojnë cilësinë e proceseve të brendshme dhe kapacitetin administrativ për të siguruar rezultate të qëndrueshme:

1.  **Burimet Njerëzore** – masin strukturën, stabilitetin dhe profesionalizmin e administratës vendore, si dhe nivelin e zhvillimit të kapaciteteve për ofrimin e shërbimeve cilësore.

2. **Transparenca** – tregon nivelin e hapjes së informacionit dhe komunikimit me qytetarët, publikimin e akteve dhe respektimin e standardeve të qeverisjes së hapur.
3.  **Barazia Gjinore** – reflekton përpjekjet institucionale për të siguruar përfaqësim të barabartë dhe përfshirje gjinore në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe politikëbërjes lokale.
4. **Integrimi në BE** – mat aftësinë e bashkisë për të përafuar praktikën e saj me standardet evropiane, përmes projekteve bashkëpunuese, partneriteteve ndërbashkiake dhe strukturave të dedikuara të integrimit.



BURIMET NJERËZORE

Përshkrim i përgjithshëm: Bashkitë kanë rol të rëndësishëm në menaxhimin e burimeve njerëzore për administratën vendore dhe strukturat e varësisë. Ky funksion përfshin planifikimin, organizimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të stafit, si dhe ndjekjen e dinamikave të personelit – duke përfshirë rekrutimin, rotacionin, trajnimin dhe raportimin vjetor të të dhënave mbi stafin aktiv dhe të larguar. Qëllimi është të sigurohet një trupë administrative efektive, e kualifikuar dhe në përputhje me nevojat e ofrimit të shërbimeve publike vendore. Përmes këtij funksioni, bashkia ndjek tregues si numri i punonjësve për 1,000 banorë, përqindja e stafit të trajnuar, si dhe lëvizjet vjetore të stafit sipas gjinisë dhe njësisë.

TREGUESIT E PERFORMANCES


	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2024	Vlera 2025	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semfor
Tregues	Shkalla e rotacionit të punonjësve të bashkisë	%	8.68	6.51	-2.17	↑	-25.03%	●
Tregues	Përqindja e stafit të punësuar nga bashkia të trajnuar	%	20.79	22.53	1.74	↑	8.35%	●
Tregues	Punonjës për 1000 banorë	punonjës/1,000 banorë	13.12	13.17	0.05	↑	0.39%	●
Nen-tregues	Shkalla e rotacionit të punonjësve femra të bashkisë	%	6.26	4.26	-2.01	↑	-32.05%	●
Nen-tregues	Shkalla e rotacionit të punonjësve meshkuj të bashkisë	%	13.21	8.67	-4.53	↑	-34.33%	●
Nen-tregues	Shkalla e rotacionit të punonjësve të administratës të bashkisë	%	14.19	21.55	7.36	↓	51.84%	●
Nen-tregues	Shkalla e rotacionit të punonjësve të njësive shpenzuese të bashkisë	%	4.89	5.41	0.52	↓	10.67%	●
Nen-tregues	Përqindja e stafit femra të trajnuar	%	24.44	35.37	10.93	↑	44.71%	●



Nen-tregues	Përqindja e stafit meshkuj të trajnuar	%	13.96	10.71	-3.25	↓	-23.26%	●
Nen-tregues	Përqindja e stafit të administratës të trajnuar	%	50.97	75.43	24.46	↑	48.00%	●
Nen-tregues	Përqindja e stafit të njësive shpenzuese të trajnuar	%	0.00	0.37	0.37	↑	0.00%	●

TË DHËNAT E SHËRBIMIT

E dhëna	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
Numri i punonjësve në bashki gjatë vitit të raportimit	760	768	Numër
Numri i punonjësve të larguar nga bashkia gjatë vitit të raportimit	66	50	Numër
Popullsia e përgjithshme e bashkisë	59834	59830	Numër
Numri i punonjësve të trajnuar gjatë vitit	158	173	Numër
Numri i punonjësve të shërbimeve të nënkontraktuara në bashki gjatë vitit të raportimit	25	20	Numër




Analiza e Shërbimit

Gjatë vitit 2025 në Bashkinë Pogradec nga analiza e treguesve të burimeve njerëzore tregohet një performancë përgjithësisht pozitive, e cila reflekton përmirësime në stabilitetin e stafit dhe në zhvillimin e kapaciteteve profesionale, megjithëse shfaqen disa problematika të veçanta që kërkojnë vëmendje. Një nga zhvillimet më të rëndësishme është ulja e shkallës së rotacionit të punonjësve në bashki, e cila ka rënë nga 8.68% në 6.51%. Kjo tregon një stabilitet më të madh të stafit dhe një reduktim të largimeve nga puna, duke kontribuar në ruajtjen e eksperiencës institucionale dhe rritjen e vazhdimësisë në shërbimet publike. Ky trend pozitiv konfirmohet edhe nga ulja e rotacionit si tek punonjëset femra ashtu edhe tek punonjësit meshkuj, duke reflektuar një përmirësim të përgjithshëm në menaxhimin e burimeve

njerëzore. Po ashtu, rritja e rotacionit në njësitë shpenzuese sugjeron sfida në menaxhimin e stafit në strukturat operative, duke kërkuar masa për të përmirësuar kushtet e punës dhe motivimin e punonjësve. Në drejtim të zhvillimit profesional, vihet re një rritje e përqindjes së stafit të trajnuar, nga 20.79% në 22.53%, çka tregon një angazhim në rritjen e kapaciteteve njerëzore. Në veçanti, përmirësimi i ndjeshëm i trajnimit të stafit të administratës dhe i stafit femër është një tregues pozitiv, që kontribuon në rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe profesionalizmit institucional. Nga ana tjetër, ulja e përqindjes së stafit meshkuj të trajnuar tregon një shpërndarje jo të balancuar të mundësive për zhvillim profesional, duke evidentuar nevojën për politika më gjithëpërfshirëse në këtë drejtim. Gjithashtu, niveli shumë i ulët i trajnimit në njësitë shpenzuese tregon për një mungesë investimi në këto struktura, të cilat janë të rëndësishme për zbatimin e shërbimeve në terren. Treguesi i punonjësve për 1000 banorë paraqet një rritje shumë të lehtë, duke reflektuar një stabilitet në raportin midis stafit dhe popullsisë. Kjo tregon se nuk ka pasur ndryshime të mëdha në strukturën e punësimit, ndërkohë që rritja e numrit total të punonjësve është minimale.

Përfundim Në përfundim, mund të thuhet se bashkia ka bërë përpjekje në drejtim të stabilitetit të stafit dhe rritjes së kapaciteteve profesionale, por mbeten sfida në menaxhimin e rotacionit në disa sektorë specifikë dhe në shpërndarjen e barabartë të trajnimeve. Për të përmirësuar më tej performancën, është e nevojshme të forcohen politikat e menaxhimit të burimeve njerëzore, të rritet investimi në trajnime dhe të adresohen problematikat në sektorët me rotacion të lartë.

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Fusha	Sfida kryesore	Arritjet 2025	Objektivat 2026
 Burimet Njerëzore	<ul style="list-style-type: none"> -Rritje e rotacionit në administratë -Pabarazi gjinore në trajnim - Nivel i ulët trajnimesh në njësitë shpenzuese 	<ul style="list-style-type: none"> -Ulje e rotacionit të stafit (8.68%→6.51%) -Ruajtje e balancës gjinore. -Rritja e numrit të punonjësve të trajnuar. 	<ul style="list-style-type: none"> -Përmirësim i politikave të burimeve njerëzore -Zgjerim i programeve të trajnimit -Ruajtje e nivelit të ulët të rotacionit dhe forcim i stabilitetit institucional.



TRANSPARENCA

Përshkrim i përgjithshëm : Transparenca dhe llogaridhënia janë elementë thelbësorë të qeverisjes së mirë në nivel vendor. Bashkia ka detyrimin të sigurojë pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin vendimmarrës, të publikojë informacionin mbi veprimtarinë institucionale dhe të japë llogari për realizimin e detyrave të tyre. Këto parime përforcojnë besimin e publikut, përmirësojnë shërbimet dhe parandalojnë abuzimet me pushtetin.

Në këtë kuadër, bashkia duhet të garantojë : (i) zhvillimin e konsultimeve publike për aktet me ndikim në komunitet ; (ii) publikimin e vendimeve të Këshillit Bashkiak dhe dokumenteve të rëndësishme si Plani Buxhetor Afatmesëm, Paketa Fiskale dhe raportet vjetore të transparencës ; (iii) hartimin dhe zbatimin e planeve të integritetit për të forcuar etikën institucionale.

TREGUESIT E PERFORMANCËS

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2024	Vlera 2025	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor
Tregues	Akte për të cilët është i detyrueshëm zhvillimi i konsultimit publik	%	100.00	100.00	0.00	→	0.00%	●
Tregues	Raporti vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes	Cilësore	0.00	1.00	1.00	↑	0.00%	●
Tregues	Plani Vendor i Integritetit	Cilësore	1.00	1.00	0.00	→	0.00%	●

TË DHËNAT E SHËRBIMIT

E dhëna	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
Numri i akteve gjithsej për të cilat është i detyrueshëm zhvillimi i konsultimit publik	10	17	Numër
Numri i akteve për të cilët është zhvilluar konsultimi publik	10	17	Numër
Publikimi i raportit vjetor për transparencën	0	1	Cilësore (Po=1/Jo=0)
Plani Vendor i Integritetit, i miratuar ose zbatuar gjatë periudhës së raportimit	1	1	Cilësore (Po=1/Jo=0)



Akte për të cilët është i detyrueshem konsultimi publik viti 2024-2025



AKTE PËR TË CILËT ËSHTË I DETYRUESHËM ZHVILLIMI I KONSULTIMIT PUBLIK

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Fusha	Sfidat kryesore	Arritjet 2025	Objektivat 2026
<input type="checkbox"/> Transparenca	<ul style="list-style-type: none"> -Nevoja e zgjerimit te bashkepunimit me qytetarët përmes platformave digjitale. - Të bëhet rritja e pjesëmarrjes qytetare në procesin e vendimmarrjes. 	<ul style="list-style-type: none"> -Publikim i rregullt i dokumenteve. -Publikim i raportit vjetor per transparence. -Zbatim i planit të Integritetit. 	<ul style="list-style-type: none"> -Zbatimi i planit te integritetit. -Rritje e konsultimeve dhe krijimi i platformave digjitale. -Rritja e cilesise dhe saktësisë të informacionit publik për qytetarët.

Analiza e Shërbimit

Analiza e treguesve të performancës në fushën e transparencës tregon një situatë përgjithësisht pozitive nëpërmjet respektimit të detyrimeve ligjore, por njëkohësisht evidenton nevojën për thellim të mëtejshëm në cilësinë dhe efektivitetin e këtyre proceseve. "Akte për të cilët është i detyrueshëm zhvillimi i konsultimit publik" paraqitet në nivelin maksimal prej 100% si në vitin e kaluar ashtu edhe në vitin aktual, duke treguar se për të gjitha aktet e identifikuara është realizuar procesi i konsultimit publik. Kjo reflekton një përputhshmëri të plotë me kërkesat ligjore dhe një angazhim të qëndrueshëm të bashkisë për të garantuar përfshirjen e publikut në vendimmarrje. Në lidhje me treguesin "Raporti vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes", vihet re një përmirësim i rëndësishëm, pasi nga mungesa e tij në vitet e mëparshme, në vitin aktual ky raport është hartuar dhe publikuar. Ky zhvillim përbën një



hap konkret drejt rritjes së llogaridhënies dhe transparencës institucionale, pasi ofron një pasqyrë të strukturuar mbi mënyrën se si janë zhvilluar proceset vendimmarrëse dhe sa transparente kanë qenë ato. Ndërkohë, treguesi "Plani Vendor i Integritetit" mbetet konstant në nivelin 1, duke treguar se ky plan ekziston dhe vazhdon të jetë në fuqi gjatë periudhës së raportimit. Kjo tregon një stabilitet në politikat e integritetit dhe një vazhdimësi në përpjekjet për të garantuar etikë dhe standarde të larta në administratë. Në përfundim, treguesit dëshmojnë se bashkia ka arritur të përmbushë detyrimet kryesore ligjore në fushën e transparencës dhe ka bërë hapa përpara në drejtim të raportimit dhe llogaridhënies. Megjithatë, analiza sugjeron se fokusi ka qenë më shumë në përmbushjen të kërkesave, ndërsa sfida kryesore mbetet rritja e cilësisë së proceseve, përfshirja reale e qytetarëve dhe sigurimi që mekanizmat e transparencës të kenë ndikim të prekshëm në vendimmarrje.



BARAZIA GJINORE

Përshkrim i përgjithshëm: Barazia gjinore në bashki është një element kyç për ndërtimin e institucioneve demokratike, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse. Ajo nënkupton jo vetëm balancën në përfaqësim midis grave dhe burrave në pozicione drejtuese, por edhe integrimin sistematik të perspektivës gjinore në të gjitha proceset vendimmarrëse, politikat publike dhe ofrimin e shërbimeve. Në këtë kontekst, bashkia duhet të garantojë: • pjesëmarrje të barabartë gjinore në strukturat vendimmarrëse dhe administrative; • buxhetim të përgjigjshëm gjinor sipas parashikimeve në legjislacionin në fuqi; • ofrim shërbimesh që adresojnë në mënyrë të barabartë nevojat e ndryshme të grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve, në të gjithë diversitetin e tyre; • mekanizma për mbrojtjen nga diskriminimi gjinor, diskriminimi për shkak të përkatësisë së shumëfishtë dhe dhuna me bazë gjinore. Bashkia është e detyruar të raportojë jo vetëm për përfaqësimin gjinor në pozicione kyçe, por edhe për masat e marra për të zbatuar barazinë gjinore në praktikë, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe angazhimet ndërkombëtare.


TË DHËNAT E SHËRBIMIT

E dhëna	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
Numri gjithsej i pozicioneve drejtuese në bashki (Kryetare/Kryetar Bashkie, zv.Kryetare/zv.Kryetar Bashkie, Administratore/Administrator, Anëtare/Anëtarë në Këshill Bashkiak).	42	42	Numër
Numri i grave në pozicione drejtuese në bashki: Kryetare, zv.Kryetare, Anëtare në Këshill Bashkiak dhe Administratore	17	17	Numër
Numri i pozicioneve drejtuese të ndryshme (të lartë, të mesme, të ulët)	39	36	Numër
Numri i grave në pozicione drejtuese të ndryshme (të lartë, të mesme, të ulët)	20	20	Numër
Plan Vendor Veprimi për Barazinë Gjinore, i miratuar ose zbatuar gjatë periudhës së raportimit	0	1	Cilësore (Po/Jo).



TREGUESIT E PERFORMANCËS

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2024	Vlera 2025	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor
Tregues	Përqindja e grave në pozicione: kryetare, zv.kryetare, anëtare në këshill bashkiak dhe administratore	%	40.48	40.48	0.00	→	0.00%	●
Tregues	Përqindja e grave në pozicione drejtuese të ndryshme (të lartë, të mesme, të ulët) në bashki	%	51.28	55.56	4.27	↑	8.33%	●
Tregues	Plan Vendor Veprimi për Barazinë Gjinore	Cilësore (Po/Jo)	0.00	1.00	1.00	↑	0.00%	●



Analiza e Shërbimit

Në vitin 2025, Bashkia Pogradec ka përmirësim në përfaqësimin e grave në nivele drejtuese, është bërë një hap i rëndësishëm me miratimin e planit Vendor për Barazinë Gjinore por mungon progres në përfaqësimin politik dhe në zgjerimin e treguesve . Është ruajtur nivel te qëndrueshëm të grave në pozicione drejtuese (40.48%), duke treguar vazhdimësi në promovimin e balancës gjinore në administratë. Në aspektin praktik, përfaqësimi i grave në nivele të larta, të mesme dhe të ulëta ka ruajtur një përfaqësim të lartë të drejtimit. Ky përmirësim tregon një balancë më të mirë gjinore në administratën e brendshme dhe një prirje pozitive drejt fuqizimit të grave në role menaxheriale dhe ekzekutive. Ndërsa pjesëmarrja në trajnime është përmirësuar. Pozitiv mbetet fakti që Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore është



miratuar në përputhje me kërkesat e legjislacionit kombëtar dhe angazhimit ndërkombëtar për barazi dhe mosdiskriminim, duke garantuar integrimin e perspektivës gjinore në politikat dhe praktikat e bashkisë.

Perfundime: Në përgjithësi, Bashkia Pogradec ruan stabilitet në barazinë gjinore, por duhet ndërhyrje e synuar për rritjen e përfaqësimit të grave në pozicione të zgjedhura dhe rritjen e barazise gjinore në strukturat vendimmarrëse. Zbatimi i planit vendor për barazinë gjinore është zhvillimi më i rëndësishëm sepse vendos bazën për politika konkrete dhe tregon angazhim institucional.

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Fusha	Sfida kryesore	Arritjet 2025	Objektivat 2026
Barazia Gjinore	- Mungesë progresi në vendimmarrje (këshill bashkiak, pozicione politike) (40.48%) -Barazia nuk po avancon në nivel drejtues politik.	-Miralimi i planit vendor për barazinë gjinore. -Ruajtje e përfaqësimit të lartë të grave në pozicione te ndryshme drejtuese(të lartë, të mesme, të ulët) (55%)	-Zbatimi i planit vendor për barazinë gjinore. -Politika aktive për barazi reale (jo vetëm përqindje) - Integrim i barazisë gjinore në të gjitha programet e bashkisë

INTEGRIMI NË BE

Përshkrim i përgjithshëm: Integrimi në Bashkimin Evropian nuk është vetëm një detyrë e qeverisjes qendrore, por një proces i përbashkët që përfshin të gjitha nivelet e administratës publike, përfshirë pushtetin vendor. Bashkia luan një rol kritik në afërsimin me *acquis communautaire* dhe përmbushjen e kriterëve të anëtarësimit, përmes politikave dhe shërbimeve që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e qytetarëve. Në këtë kuptim, bashkia duhet të:

- Ndërtojë kapacitete administrative për të përthithur dhe zbatuar fondet e BE-së;
- Zhvillojë plane vendore për përputhshmëri me politikat e BE-së në fusha si mjedisi, energjia, digjitalizimi, barazia gjinore, migracioni, zhvillimi rural dhe përfshirja sociale;

TREGUESIT E PERFORMANCËS

	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2024	Vlera 2025	Trendi	Simboli i trendit	Ndryshimi	Semafor
Tregues	Numri i marrëveshjeve ndërbashkiake të nënshkruara nga secila bashki	Numër	3.00	4.00	1.00	↑	33.33%	




Tregues	Ekzistenca dhe funksionimi i strukturave të performancës në bashki	Cilësore (Po/Jo)	1.00	1.00	0.00	→	0.00%	●
Tregues	Projekte të fituara kundrejt të aplikuara nga bashkimi evropian	%	37.50	100.00	62.50	↑	1.67%	●
Tregues	Planet e migracionit dhe diasporës	Cilësore (Po/Jo)	0.00	1.00	1.00	↑	0.00%	●
Tregues	Komisionet e integritit evropian pranë këshillave bashkiakë	Cilësore (Po/Jo)	0.00	1.00	1.00	↑	0.00%	●

TË DHËNAT E SHËRBIMIT

E dhëna	Vlera		Njësia Matëse
	2024	2025	
Numri i marrëveshjeve ndërbashkiake të nënshkuara	3	4	Numër
Struktura e performancës e përfshirë në organizimin funksional të bashkisë	1	1	Cilësore (Po=1/Jo=Bosh).
Strukturat e performancës ngritur pranë drejtorisë së Integritit Evropian sipas manualeve orientuese të AMVV-së	0	0	Cilësore (Po=1/Jo=0).
Numri i projekteve të BE që bashkia ka aplikuar gjatë periudhës së raportimit	8	4	Numër
Numri i projekteve të BE të fituara gjatë periudhës së raportimit	3	4	Numër
Plani Vendor i Migracionit dhe Diasporës, i miratuar apo zbatuar gjatë periudhës së raportimit	0	1	Cilësore (Po=1/Jo=0).
Komisionet e Integritit Evropian pranë Këshillave Bashkiakë	0	1	Cilësore (Po=1/Jo=0).

Projekte të fituara kundrejt të aplikuara viti 2024-2025



Analiza e Shërbimit Analiza e treguesve të performancës në fushën e integrimit evropian dhe bashkëpunimit ndërbashkiak tregon një zhvillim përgjithësisht pozitiv, duke reflektuar përpjekje të dukshme të bashkisë për të përmirësuar kapacitetet institucionale dhe për të rritur përfshirjen në procese bashkëpunimi dhe integrimi. Së pari, treguesi "Numri i marrëveshjeve ndërbashkiake të nënshkruara" ka shënuar një rritje nga 3 në 4 marrëveshje, që përkthehet në një rritje prej 33.33%. Ky zhvillim tregon një angazhim më të madh të bashkisë në bashkëpunim me njësi të tjera vendore, duke krijuar mundësi për ndarje burimesh, shkëmbim përvojash dhe zhvillim të projekteve të përbashkëta. Megjithatë, edhe pse rritja është pozitive, numri total mbetet relativisht i ulët, çka sugjeron se ka ende hapësirë për zgjerim të mëtejshëm të këtij bashkëpunimi. Një nga treguesit më të rëndësishëm është ai i projekteve të fituara kundrejt atyre të aplikuara nga Bashkimi Evropian, i cili ka kaluar nga 37.5% në 100%. Në pamje të parë, kjo paraqet një përmirësim shumë të madh dhe një sukses të rëndësishëm në përfshirjen e fondeve. Megjithatë, analiza e detajuar tregon se ky rezultat vjen edhe si pasojë e uljes së numrit të aplikimeve (nga 8 në 4), ndërkohë që numri i projekteve të fituara është rritur në 4. Kjo nënkupton se bashkia ka qenë më selektive dhe më e kujdesshme në aplikime, duke rritur cilësinë e tyre, por njëkohësisht mund të ketë kufizuar shtrirjen e mundësive për financim. Treguesi "Planet e migracionit dhe diasporës" ka kaluar nga 0 në 1, duke treguar se bashkia ka ndërmarrë hapa konkretë për hartimin dhe/ose zbatimin e një plani në këtë fushë. Ky është një zhvillim i rëndësishëm, në lidhje me migracionin dhe përfshirjen e diasporës në zhvillimin lokal. Në mënyrë të ngjashme, edhe treguesi për "Komisionet e integrimit evropian pranë këshillave bashkiakë" ka kaluar nga 0 në 1, duke reflektuar një përfundim të strukturave vendimmarrëse dhe mbikëqyrëse në këtë drejtim. Për këtë arsye, është e rëndësishme që bashkia të fokusohet në rritjen e kapaciteteve profesionale dhe zgjerimin e pjesëmarrjes në programe dhe iniciativa ndërkombëtare. Në përfundim, megjithëse performanca paraqitet pozitive dhe në përmirësim, ajo duhet të shihet si një bazë për zhvillime të mëtejshme dhe jo si një objektivi i arritur plotësisht, duke kërkuar vazhdimësi në investime, përmirësim të cilësisë së proceseve dhe një qasje në shfrytëzimin e mundësive që ofron integrimi evropian.



PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Fusha	Sfida kryesore	Arritjet kryesore 2025	Objektivat 2026
EU Integrimi në BE	-Ulje e numrit të aplikimeve të reja të projekteve BE. -Dhe pse ka rritje të projekteve të fituara, sfida mbetet menaxhimi i projekteve dhe zbatimi cilesor.	-Miratimi i planit për migracionin dhe diasporën.- Rritje e projekteve të fituara. -Janë ngritur komisionet e integritetit evropian pranë KB .-Nënshkruar 1 marrëveshje ndërbashkiake	-Zbatimi i planit për migracionin dhe diasporën. -Rritje e projekteve të aplikuar dhe të fituara. -Zgjerim i bashkëpunimeve ndërbashkiake. -Komisionet të jenë konkrete dhe aktive. -Forcimi i strukturave të performancës .

MENAXHIMI FINANCIAR

Përshkrim i përgjithshëm: Menaxhimi financiar është një funksion kyç për sigurimin e qëndrueshmërisë dhe eficiencës së qeverisjes vendore. Ai përfshin planifikimin, administrimin dhe raportimin e burimeve financiare të bashkisë, në përputhje me parimet e përgjegjshmërisë dhe transparencës. Në përmbushjen e këtij funksioni, bashkitë udhëhiqen nga kuadri ligjor për financat vendore, përfshirë Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe Ligjin Nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore". Kjo kategori ndahet në tre fusha të veçanta që mbulojnë ciklin financiar: të ardhurat, shpenzimet, dhe buxheti. Vlerësimi i këtyre fushave ndihmon në monitorimin e kapaciteteve financiare të bashkive dhe në analizimin e performancës së tyre në përdorimin dhe menaxhimin e burimeve publike.

TREGUESIT E PERFORMANCËS

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2024	Vlera2025	Trendi	Simboli i trendit	Ndryshimi	Semaf or
Tregues	Të ardhurat e veta për frymë	leke/ person	7918.21	8832.83	914.62	↑	11.55%	●
Tregues	Të ardhurat e veta përkundrejt transfertave	%	58.29	53.12	-5.17	↓	-8.87%	●
Tregues	Raporti i të ardhurave të veta ndaj buxhetit	%	36.83	34.69	-2.13	↓	-5.79%	●
Tregues	Shkalla e përdorimit të të ardhurave	%	97.70	93.98	-3.72	↓	-3.80%	●

Tregues	Të ardhurat nga taksa e pasurisë ne raport me të ardhurat vendore	%	16.99	16.42	-0.57	↓	-3.35%	●
Tregues	Buxheti i miratuar për frymë	leke/person	26493.40	30405.42	3912.02	↑	14.77%	●
Tregues	Shkalla e ekzekutimit të buxhetit	%	79.29	78.70	-0.60	↓	-0.75%	●
Tregues	Investime për frymë	leke/person	2770.33	2958.28	187.95	↑	6.78%	●
Tregues	Pesha e investimeve në buxhet	%	13.19	12.36	-0.82	↓	-6.25%	●
Tregues	Pesha e detyrimeve financiare të papaguara ndaj të tretëve	%	18.94	15.38	-3.56	↑	-18.81%	●
Tregues	Pesha e personalit në buxhet	%	48.47	52.11	3.63	↑	7.50%	●
Tregues	Pesha e shpenzimeve operacionale në buxhet	%	38.34	35.53	-2.81	↓	-7.33%	●

TË DHËNAT E SHËRBIMIT

E dhëna	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
Të ardhurat e veta, fakt	473778	528468	Mijë Leke
Popullsia e përgjithshme e bashkisë	59834	59830	Numër
Transfertat gjithsej, fakt	812781	994846	Mijë Leke
Të ardhurat e përgjithshme, fakt	1286559	1523314	Mijë Leke
Totalit i shpenzimeve të bashkisë , fakt	1256988	1431674	Mijë Leke
Të ardhurat nga taksa e pasurisë, fakt	80492	86778	Mijë Leke
Shpenzime gjithsej, plan i rishikuar	1585206	1819156	Mijë Leke
Shpenzime kapitale, fakt	165760	176994	Mijë Leke
Detyrime të papaguara mbi 30 ditë	238093	220181	Mijë Leke
Shpenzime personeli, fakt	609294	745984	Mijë Leke
Shpenzime operacionale, fakt	481934	508696	Mijë Leke

Të ardhurat, shpenzimet dhe investimet në lekë/banor, viti 2024-2025



Analiza e Shërbimit: Për vitin 2025, bashkia ka ruajtur një pozicion të qëndrueshëm fiskal, duke shënuar përmirësim në shumicën e treguesve të performancës financiare. Të ardhurat e veta për frymë u rritën nga 7918.21 lekë në 8832.83lekë ,ndërsa pesha e tyre ndaj transfertave u ul me (-8.87%), duke reflektuar një nivel të ulët të vetëfinancimit lokal dhe varesi nga fondet qendrore. Po ashtu, raporti i të ardhurave të veta ndaj buxhetit u ul me (-5.79%), duke sinjalizuar ulje të pavaresise vendore në strukturën e përgjithshme të buxhetit. Në të njëjtën kohë pozitive është se investimet për frymë u rritën, nga 2770.33lekë në 2958.28lekë (+6.78%), ndërsa pesha e investimeve në buxhet u ul nga 13.19% në 12.36%, një tregues ky sepse buxheti po shkon me shume per shpenzime te tjera. Shkalla e ekzekutimit te buxhetit ka nje rënje te lehtë nga (-0,75%), duke reflektuar efikasitet të ulët në menaxhimin e shpenzimeve. Nga ana tjetër, detyrimet e papaguara ndaj të tretëve janë ulur, nga 11.05% në vetëm 9.75% të totalit të shpenzimeve, një arritje që tregon disiplinë buxhetore dhe menaxhim të kujdesshëm të likuiditetit dhe më pak borxhe ndaj të tretëve. Ndërsa pjesa e shpenzimeve të personelit është rritur me (+7,50%)kjo tregon rritje te kostos se personelit, dhe shpenzimet operacionale janë ulur me (-7.33%) duke krijuar hapësirë më të madhe për investime dhe shërbime të reja.

Përfundime: Në tërësi, performanca financiare e vitit 2025 vlerësohet pozitive, me rritje të të ardhurave vendore dhe përmirësim të disiplinës fiskale. Sfidat për periudhën në vijim mbetet rritja e mëtejshme e autonomisë financiare dhe larmishmëria e burimeve të financimit, rritja e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, si dhe forcimi i kapaciteteve për menaxhimin afatmesëm të buxhetit në përputhje me parimet e qeverisjes së mirë.



PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Fusha	Sfida kryesore	Arritjet 2025	Objektivat 2026
<input checked="" type="checkbox"/> Menaxhimi Financiar	<ul style="list-style-type: none"> -Nevoja për rritje të mëtejshme të autonomisë financiare, që ende mbështeten në transfertat qendrore. -Përdorim me efikas i te ardhurave dhe planifikim me i mire financiar. - Hapësirë për zgjerim të bazës së të ardhurave vendore. 	<ul style="list-style-type: none"> -Rritje e të ardhurave vendore per fryme . -Rritje e buxhetit. -Ulje e detyrimeve të papaguara ndaj të tretëve. -Rritje e investimeve. 	<ul style="list-style-type: none"> -Rritja e autonomisë financiare .- Rritja e peshës së të ardhurave të veta në buxhetin e bashkisë. -Rritja e nivelit të investimeve publike. -Përmirësimi i cilesise se shërbimeve.

PLANIFIKIMI

Përshkrim i përgjithshëm: Planifikimi strategjik përbën një nga instrumentet më të rëndësishme për drejtimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të njëjësive të qeverisjes vendore. Ai synon të përcaktojë vizionin afatgjatë, prioritetet kryesore dhe objektivat konkrete që duhet të arrihen, duke u bazuar në analizën e burimeve, nevojave të komunitetit dhe potencialeve zhvillimore të territorit.

Në kontekstin e zhvillimit ekonomik dhe territorial, planifikimi strategjik shërben si një mekanizëm orientues për hartimin e politikave publike, shpërndarjen efikase të burimeve financiare dhe rritjen e transparencës në vendimmarrje. Përmes këtij procesi, sigurohet një koordinim më i mirë ndërmjet aktorëve institucionalë dhe përfshirja aktive e publikut në vendimmarrje, duke garantuar zhvillim të balancuar dhe gjithëpërfshirës.

Në veçanti, roli i planeve vendore si Plani i Përgjithshëm Vendor (PPV) dhe Planet e Detajuara Vendore (PDV) është thelbësor për menaxhimin e territorit dhe orientimin e investimeve, duke ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe zhvillimin ekonomik lokal.

Në këtë kuadër, analiza e treguesve të performancës shërben si një mjet i rëndësishëm për vlerësimin e progresit, identifikimin e sfidave dhe orientimin e ndërhyrjeve të ardhshme, duke siguruar një qasje të bazuar në të dhëna dhe rezultate konkrete.

TREGUESIT E PERFORMANCËS

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2024	Vlera 2025	Trend i	Trend Simbol	% Ndrysimi	Semator
Tregues	Shpenzimet për zhvillimin ekonomik (Programi 04130) në % të buxhetit	Mije Leke	0.00	0.00	0.00	→	0.00	●



Tregues	Përqindja e aplikimeve online për shërbime ekonomike	%	51.61	51.61	0.00	→	0.00	●
Tregues	Përqindja e territorit të mbuluar me PPV	%	100.0	100.00	0.00	→	0.00	●
Tregues	Përqindja e territorit të mbuluar me PDV	%	0.01	0.00	-0.01	↓	-0.66	●
Tregues	Ekzistenca e PPV të miratuar	po/jo (ose 1/0)	1.00	1.00	0.00	→	0.00	●
Tregues	Intensiteti i zonave ekonomike në territor	%	0.13	0.13	0.00	→	0.00	●
Tregues	Numri i zonave ekonomike të përcaktuara në PPV/PDV	Numër	9.00	9.00	0.00	→	0.00	●
Tregues	Lejeve të perfituara kundrejt aplikimeve për leje zhvillimi në zonat ekonomike	Numër	66.67	66.67	0.00	→	0.00	●
Tregues	Koha mesatare e trajtimit të lejeve të zhvillimit	ditë	45.00	45.00	0.00	→	0.00	●
Tregues	Numri i dokumenteve strategjike ekonomike të miratuara	Numër	0.00	0.00	0.00	→	0.00	●
Tregues	Numri i konsultimeve publike në fushën e ekonomisë	Numër	5.00	11.00	6.00	↑	1.20	●
Tregues	Numri i raporteve të monitorimit ekonomik	Numër	3.00	3.00	0.00	→	0.00	●
Tregues	Pjesëmarrja e bashkisë në grupe pune / komitete sektoriale	nr. takimesh / vit	3.00	4.00	1.00	↑	0.33	●

TË DHËNAT E SHËRBIMIT

Kodi i të dhënës	Kodi i Treguesit	Përdorur në treguesit	E dhëna	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
EDP06	IP04	IP04	Shpenzimet për programet e zhvillimit ekonomik (Programi 28, 04130)	0	0	Mijë Leke



D96	IP04	IP04	Totalit i shpenzimeve të bashkisë , fakt	2153836	2257395	Mijë Leke
EDP08	IP06	IP06	Numri i shërbimeve ekonomike që ofrohen online	16	16	Numër
EDP09	IP06	IP06	Numri i aplikimeve totale për shërbime ekonomike (online + fizike)	31	31	Numër
EDP10	IP13	IP13	Ekzistenca e PPV të miratuar	1	1	Cilesore Po/Jo
EDP11	IP07	IP07, IP08, IP09	Sipërfaqja e territorit të bashkisë (ha)	54900	54900	Hektarë
EDP12	IP07	IP07	Sipërfaqja e mbuluar me PPV (ha)	54900	54900	Hektarë
EDP13	IP08	IP08	Sipërfaqja e mbuluar me PDV (ha)	7.11	2.43	Hektarë
EDP14	IP10	IP10	Numri i zonave me funksion ekonomik në PPV	9	9	Numër
EDP15	IP09	IP09	Sipërfaqja e zonave ekonomike (ha)	69	69	Hektarë
EDP16	IP11	IP11	Numri i aplikimeve për leje zhvillimi(ndertimi) në zonat ekonomike	3	6	Numër
EDP17	IP12	IP12	Koha mesatare e trajtimit të lejeve te zhvillimit	45	45	Ditë
EDP18	IP14	IP14	Numri i planeve/strategjive ekonomike të miratuara (dokumente)	0	0	Numër
EDP19	IP15	IP15	Numri i konsultimeve publike në fushën e ekonomisë	5	11	Numër
EDP20	IP16	IP16	Numri i raporteve të monitorimit ekonomik (raport vjetor, gjysmëvjetor)	3	3	Numër
EDP21	IP17	IP17	Pjesëmarrja e bashkisë në grupe pune/komitete sektoriale (numër takimesh)	3	4	Numër
EDP22	IP11	IP11	Numri i lejeve të zhvillimit(ndertimi) në zonat ekonomike	2	4	Numër

Përqindja e territorit e mbuluar me PPV dhe PDV dhe e aplikimeve online për shërbime ekonomike



Analiza e Shërbimit

Nga vlerësimi i të dhënave rezulton se disa prej treguesve bazë paraqesin një qëndrueshmëri të konsiderueshme. Ekzistenca e Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV) dhe mbulimi i plotë i territorit me këtë instrument tregojnë se baza ligjore dhe planifikuese është e konsoliduar. Po ashtu, numri i zonave ekonomike të përcaktuara dhe raporti i lejeve të zhvillimit në raport me aplikimet tregojnë një nivel të pranueshëm funksionimi të mekanizmave administrativë dhe të menaxhimit të territorit. Megjithatë, përtej këtij stabiliteti, vihet re një mungesë progresi në disa tregues kyç që lidhen drejtpërdrejt me zhvillimin ekonomik. Në mënyrë të veçantë, mungesa e shpenzimeve për programet e zhvillimit ekonomik përbën një ndër problematikat më të theksuara, duke reflektuar një nivel të ulët prioriteti financiar për këtë sektor. Pa një mbështetje buxhetore konkrete, zbatimi i politikave zhvillimore mbetet i kufizuar dhe me ndikim të reduktuar në terren. Një tjetër element kritik është mungesa e dokumenteve strategjike ekonomike të miratuara, çka tregon për një boshllëk në orientimin afatgjatë të zhvillimit. Kjo situatë e bën të vështirë përcaktimin e prioritetëve të qarta dhe krijimin e një vizioni të integruar për zhvillimin ekonomik lokal. Në të njëjtën linjë, rënia e mbulimit me Plane të Detajuara Vendore (PDV) tregon për një dobësim në planifikimin operacional të territorit, duke ndikuar negativisht në zbatimin konkret të projekteve dhe investimeve. Nga ana tjetër, treguesit që lidhen me digjitalizimin dhe ofrimin e shërbimeve publike paraqesin një ngadalesim, siç është rasti i përqindjes së aplikimeve online, e cila nuk ka pësuar përmirësim. Në kontrast me këto zhvillime, vërehet një përmirësim i ndjeshëm në drejtim të përfshirjes së publikut dhe bashkëpunimit institucional. Rritja e numrit të konsultimeve publike dhe pjesëmarrja më aktive në grupe pune dhe komitete sektoriale tregojnë një angazhim më të madh të institucionit në drejtim të transparencës dhe bashkëpunimit. Ky është një zhvillim pozitiv që mund të shërbejë si bazë për forcimin e proceseve vendimmarrëse dhe përfshirjen e aktorëve të ndryshëm në zhvillimin lokal.

Përfundim: Analiza e treguesve të performancës tregon se, ndonëse ekziston një strukturë e qëndrueshme planifikuese dhe institucionale, zhvillimi ekonomik dhe strategjik mbetet i kufizuar nga mungesa e investimeve, dokumenteve strategjike dhe përmirësimeve në eficiencën administrative. Për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, është e domosdoshme që të ndërmerren masa konkrete në drejtim të forcimit të planifikimit strategjik, rritjes së financimit për sektorët prioritarë dhe përmirësimit të mekanizmave të zbatimit dhe monitorimit.



PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Fusha	Sfida kryesore	Arritjet 2025	Objektivat 2026
Planifikimi strategjik	<ul style="list-style-type: none"> -Mungesë financimi për zhvillim ekonomik - Mungesë e strategjive ekonomike (0 dokumente) -Rënie e mbulimit me PDV - Aplikime online pa rritje - Shfrytëzimi i ulët i zonave ekonomike 	<ul style="list-style-type: none"> -Rritje e konsultimeve publike (5 → 11) - Përmirësim i bashkëpunimit institucional (3 → 4 takime) - Mbulim 100% i territorit me PPV - Numër i qëndrueshëm i zonave ekonomike (9) - Stabilitet në procesin e dhënies së lejeve 	<ul style="list-style-type: none"> - Rritje e buxhetit për zhvillim ekonomik - Hartim dhe miratim strategjish ekonomike - Zgjerim i Planeve të Detajuara Vendore (PDV) - Rritje e shërbimeve online - Aktivizim i zonave ekonomike për investime - Përmirësim i sistemit të të dhënave ekonomik

SHËRBIME PUBLIKE TË TJERA

Shërbimet publike që ofron bashkia kanë një rol thelbësor në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve dhe në zhvillimin e qëndrueshëm të territorit. Ndër sektorët më të rëndësishëm që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e përditshme të komunitetit janë shërbimet e rrugëve, ndriçimit publik, mirëmbajtjes së varrezave, sportit, kulturës dhe gjelbërimit. Këto shërbime përbëjnë bazën e funksionimit normal të qytetit dhe ndikojnë jo vetëm në infrastrukturë, por edhe në mirëqenien sociale, sigurinë, zhvillimin ekonomik dhe imazhin urban të bashkisë. Shërbimi i rrugëve ka një rëndësi të veçantë pasi garanton lëvizjen e sigurt dhe efikase të qytetarëve, mjeteve dhe aktiviteteve ekonomike. Investimet në ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e aksesit ndërmjet zonave urbane dhe rurale, uljen e kohës së transportit dhe rritjen e sigurisë rrugore. Një infrastrukturë rrugore funksionale ndihmon në zhvillimin ekonomik lokal, nxit turizmin dhe krijon kushte më të mira për jetesë. Ndriçimi publik është një tjetër komponent i rëndësishëm i shërbimeve bashkiake, pasi ndikon në sigurinë e qytetarëve dhe në përmirësimin e ambienteve publike. Një sistem ndriçimi i mirëmbajtur rrit sigurinë gjatë natës, redukton riskun e aksidenteve dhe kontribuon në krijimin e hapësirave më të aksesueshme dhe më funksionale për komunitetin. Gjithashtu, përdorimi i teknologjive moderne dhe eficientë energjetike ndihmon në uljen e kostove dhe mbrojtjen e mjedisit. Një rol të rëndësishëm në përmirësimin e mjedisit urban luan edhe sektori i gjelbërimit. Hapësirat e gjelbra, parqet dhe ambientet rekreative kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së ajrit, uljen e ndotjes dhe krijimin e një ambienti më të shëndetshëm për qytetarët. Gjelbërimi ndikon gjithashtu në estetikën e qytetit dhe në rritjen e cilësisë së jetesës, duke ofruar hapësira çlodhëse dhe rekreative për komunitetin. Mirëmbajtja e varrezave përfaqëson një shërbim me rëndësi sociale dhe humane për komunitetin. Bashkia ka përgjegjësi për administrimin, sistemin dhe mirëmbajtjen e këtyre hapësirave, duke garantuar kushte dinjtoze dhe të rregullta për qytetarët. Kujdesi për varrezat lidhet ngushtë me respektin ndaj traditës, memories familjare dhe vlerave shoqërore. Sporti dhe kultura janë elementë të rëndësishëm për zhvillimin social dhe edukativ të komunitetit. Përmes mbështetjes së aktiviteteve sportive dhe kulturore, bashkia krijon mundësi për përfshirjen e të rinjve, promovimin e talenteve dhe forcimin e jetës komunitare. Investimet në terrene sportive, qendra kulturore dhe organizimin e aktiviteteve artistike e sportive ndikojnë pozitivisht në edukimin, argëtimin dhe promovimin e identitetit lokal. Në tërësi, këto shërbime përbëjnë një pjesë të rëndësishme të funksioneve të bashkisë dhe kërkojnë planifikim, menaxhim dhe investime të vazhdueshme për të garantuar zhvillim të qëndrueshëm dhe shërbime cilësore për qytetarët.



TREGUESIT E PERFORMANCËS (RRJETI RRUGOR)

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2024	Vlera 2025	Trendi	Simboli	% Ndryshimi	Semafor
Tregues	Përqindja e rrjetit rrugor të shtruar	%	28.34	43.53	15.19	↑	53.61%	●
Tregues	Përqindja e rrjetit me sinjalistikë	%	73.18	73.18	0.00	→	0.00%	●
Tregues	Gjatësia e rrjetit rrugor të mirëmbajtur në vit	km	112.30	2.50	-109.80	↓	-97.77%	●
Tregues	Shpenzimet për km rrjet rrugor	Mije Leke/km	126311.72	213153.58	86841.87	↑	68.75%	●
Nëntregues	Gjatësia e mirëmbajtur - Urban	km	67.20	2.50	-64.70	↓	-96.28%	●
Nëntregues	Gjatësia e mirëmbajtur - Rural	km	42.60	0.00	-42.60	↓	-100.00%	●
Nëntregues	Gjatësia e mirëmbajtur - Urban	km	67.20	2.50	-64.70	↓	-96.28%	●
Nëntregues	Gjatësia e mirëmbajtur - Rural	km	42.60	0.00	-42.60	↓	-100.00%	●



TË DHËNAT E SHERBIMIT (RRJETI RRUGOR)

Kodi i të dhënës	Kodi i Treguesit	Përdorur në treguesit	E dhëna	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
DSRR01	RR01	RR01	Gjatësia e rrjetit rrugor të shtruar	249	382.5	Km
DSRR02	RR01	RR01, RR02, RR04, KU01, KU02, KU04, SP01, SP02, SP04, SP05	Gjatësia totale e rrjetit rrugor	878.62	878.62	Km
DSRR03	RR02	RR02	Rrjet rrugor me sinjalistikë	642.98	642.98	Km
DSRR04	RR03	RR03	Rrjet rrugor i mirëmbajtur	120.5	133.5	Km
DSRR05	RR04	RR04	Shpenzime për rrjetin rrugor	110980000	187281000	Lekë
DSRR06	RR05	RR05	Popullsia e mbuluar me rrjet rrugor	59834	59830	numër
D57	RR05	RR05, GJ01	Popullsia totale e bashkise	59834	59830	numër



TREGUESIT E PERFORMANCËS (RRJETI I NDRIÇIMIT)

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2024	Vlera 2025	Trendi	Si mboll	% Ndryshimi	Semafori
Tregues	Gjatësia e rrjetit të ndriçimit të mirëmbajtur	km	132.57	132.57	0.00	→	0.00%	●
Tregues	Shpenzime për ndriçimin publik	Mijë Lekë	9719381	11644977	1925596	↑	19.81%	●
Tregues	Të ardhura nga tarifa e ndriçimit	Mijë Lekë	36946740	31028603	-5918137	↓	-16.02%	●
Tregues	% e sipërfaqes publike të mbuluar me ndriçim	%	0.10	0.10	0.00	→	0.00%	●
Tregues	Numri i pikave të ndriçimit funksionale	numër	3662.00	3702.00	40.00	↑	1.09%	●
Nëntregues	Gjatësia e mirëmbajtur - Urban	km	69.00	69.00	0.00	→	0.00%	●
Nëntregues	Gjatësia e mirëmbajtur - Rural	km	63.57	63.57	0.00	→	0.00%	●
Nëntregues	Gjatësia e mirëmbajtur - Urban	km	69.00	69.00	0.00	→	0.00%	●
Nëntregues	Gjatësia e mirëmbajtur - Rural	km	63.57	63.57	0.00	→	0.00%	●



TË DHËNAT E SHERBIMIT (RRJETI I NDRIÇIMIT)

Kodi i të dhënës	Kodi i Treguesit	Përdorur në treguesit	E dhëna	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
DSNP01	NP01	NP01	Gjatësia e rrjetit të ndriçimit të mirëmbajtur	132.57	132.57	Km
DSNP02	NP02	NP02	Shpenzime per sherbimin e ndriçimit	9719381	11644977	Lekë
DSNP03	NP03	NP03	Të ardhura nga taksa e ndriçimit	36946740	31028603	Lekë
DSNP04	NP04	NP04	Sipërfaqe totale publike e ndriçuar	0.53	0.53	Km ²
DSNP05	NP04	NP04	Sipërfaqe publike totale	549	549	Km ²
DSNP06	NP05	NP05	Numri i pikave te ndriçimit funksional	3662	3702	numër

TREGUESIT E PERFORMANCËS (GJELBËRIMI)

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2024	Vlera 2025	Trendi	Simboli	% Ndryshimi	Semafor
Tregues	Sipërfaqe e gjelbër publike për frymë	m ² /banor	5.16	5.16	0.00	↑	0.01%	
Tregues	Sipërfaqja publike e mbuluar me gjelbërim	%	0.06	0.06	0.00	→	0.00%	
Tregues	Shkalla e mirëmbajtjes e sipërfaqes te	%	23.10	23.10	0.00	→	0.00%	



	gjelbër publike gjatë vitit							
Tregues	Shpenzim për m ² gjelbërim publik	mije Lekë/m ²	7.17	4.16	-3.01	↓	-41.96%	●
Tregues	Numri i pemëve të mbjella gjatë vitit	numër	120.00	113.00	-7.00	↓	-5.83%	●
Nëntregues	m ² gjelbërim publik për frymë - Urban	m ² /banor	12.02	12.85	0.83	↑	6.94%	●
Nëntregues	m ² gjelbërim publik për frymë - Rural	m ² /banor	0.00	0.00	0.00	→	0.00%	●
Nëntregues	Sipërfaqja publike urbane e mbuluar me gjelbërim	%	0.01	0.01	0.00	→	0.00%	●
Nëntregues	Sipërfaqja publike rurale e mbuluar me gjelbërim	%	0.00	0.00	0.00	→	0.00%	●

TË DHËNAT E SHERBIMIT (GJELBËRIMI)

Kodi i të dhënës	Kodi i Treguesit	Përdorur në treguesit	E dhëna	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
D57	RR05	RR05, GJ01	Popullsia totale e bashkise	59834	59830	numër
DSGJ01	GJ01	GJ01, GJ02, GJ03, GJ04	Sipërfaqe e gjelbër publike (rurale + urbane)	308960	308960	m ²
DSGJ03	GJ02	GJ02	Sipërfaqe totale publike e bashkise	549000000	549000000	m ²



DSGJ04	GJ03	GJ03	Sipërfaqe publike (urbane dhe rurale) e mirëmbajtur me gjelberim gjatë vitit	71379	71379	m ²
DSGJ05	GJ04	GJ04	Shpenzime totale për gjelbërim	2214930	1285600	Lekë
DSGJ06	GJ05	GJ05	Numri i pemëve të mbjella	120	113	Nr

TREGUESIT E PERFORMANCËS (VARREZAT)

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2024	Vlera 2025	Trendi	Simboli	% Ndryshimi	Semafor
Tregues	% varresh me mirëmbajtje sipas planit	%	100.00	100.00	0.00	→	0.00%	●
Tregues	Kapacitet i lirë i varrezave	%	53.34	52.72	-0.62	↓	-1.16%	●
Tregues	Koha mesatare e përpunimit të një kërkesë	ditë	0.00	0.00	0.00	↑	3.45%	●
Tregues	Shpenzim për varr aktiv	Lekë/varr	39.76	28.28	-11.47	↓	-28.86%	●
Tregues	Të ardhura nga tarifat e varrezave	Lekë	10355464	9048666	-1306798	↓	-12.62%	●

TË DHËNAT E SHERBIMIT (VARREZAT)

Kodi i të dhënës	Kodi i Treguesit	Përdorur në treguesit	E dhëna	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
DSVR01	VR01	VR01	Njësi/zonë e mirëmbajtur sipas planit	139	139	numër
DSVR02	VR01	VR01	Njësi/zonë totale për mirëmbajtje	139	139	numër



DSVR03	VR02	VR02	Vende/parcelë të lira	45025	44503	numër
DSVR04	VR02	VR02	Kapacitet total (vende/parcelë)	84408	84408	numër
DSVR05	VR03	VR03	Totali i ditëve të përpunimit (sum)	1	1	ditë
DSVR06	VR03	VR03	Numri i kërkesave të përpunuara	540	522	Nr
DSVR07	VR04	VR04	Shpenzime totale për varreza	1565661	1128540	Lekë
DSVR08	VR04	VR04	Numri i varreve aktive	39382	39904	numër
DSVR09	VR05	VR05	Të ardhura nga tarifat	10355464	9048666	Lekë

TREGUESIT E PERFORMANCËS (KULTURA)

Lloj	Emri	Njësi a Matëse	Vlera 2024	Vlera 2025	Trendi	Simboli	% Ndryshimi	Semafor
Tregues	Numri i aktiviteteve kulturore për 1,000 banorë	Nr/1000 banorë	1.40	3.28	1.87	↑	133.35%	●
Tregues	Numri i pjesëmarrësve në aktivitete kulturore për 1,000 banorë	Nr/1000	183.84	229.32	45.47	↑	24.74%	●
Tregues	% objekteve kulturore funksionale	%	70.00	70.00	0.00	→	0.00%	●
Tregues	Shpenzim për banor për kulturë	mije Lekë /banor	0.30	2.25	1.95	↑	656.37%	●



Tregues	Të ardhura nga aktivitetet kulturore	Mije Lekë	62900	728900	666000	↑	1058.82%	●
---------	--------------------------------------	-----------	-------	--------	--------	---	----------	--------------------------------------

TË DHËNAT E SHERBIMIT (KULTURA)

Kodi i të dhënës	Kodi i Treguesit	Përdorur në treguesit	E dhëna	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
D57	RR05	RR05, GJ01	Popullsia totale e bashkise	59834	59830	numër
DSKU01	KU01	KU01	Numri total i aktiviteteve kulturore	84	196	numër
DSKU03	KU02	KU02	Numri total i pjesëmarrësve	11000	13720	numër
DSKU04	KU03	KU03	Objekte kulturore funksionale	7	7	numër
DSKU05	KU03	KU03	Objekte kulturore totale	10	10	numër
DSKU06	KU04	KU04	Shpenzime totale për kulturë	17810	134700	Mije Lekë
DSKU07	KU05	KU05	Të ardhura nga aktivitetet	62900	728900	Mije Lekë

TREGUESIT E PERFORMANCËS (SPORTI)

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2024	Vlera 2025	Trendi	Simboli	% Ndryshimi	Semafor
Tregues	Numri i aktiviteteve sportive për 1,000 banorë	Nr/1000	1.17	1.57	0.40	↑	34.29%	●
Tregues	Numri i pjesëmarrësve në aktivitete sportive për 1,000 banorë	Nr/1000	15.04	30.09	15.04	↑	100.01%	●
Tregues	% objekteve sportive funksionale	%	57.14	57.14	0.00	→	0.00%	●




Tregues	Shpenzim për banor për sport & argëtim	Lekë/banor	0.10	0.12	0.02	↑	23.98%	●
Tregues	Sipërfaqe sportive publike për frymë	m ² /banor	1.01	1.01	0.00	↑	0.01%	●

TË DHËNAT E SHERBIMIT (SPORTI)

Kodi i të dhënës	Kodi i Treguesit	Përdorur në treguesit	E dhëna	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
D57	RR05	RR05, GJ01	Popullsia totale e bashkise	59834	59830	numër
DSSP01	SP01	SP01	Numri total i aktiviteteve sportive	70	94	numër
DSSP03	SP02	SP02	Numri total i pjesëmarrësve	900	1800	numër
DSSP04	SP03	SP03	Objekte sportive funksionale	4	4	numër
DSSP05	SP03	SP03	Objekte sportive totale	7	7	numër
DSSP06	SP04	SP04	Shpenzime totale për sport	5783	7169	Mije Lekë
DSSP07	SP05	SP05	Sipërfaqe sportive publike	60253	60253	m ²



Disa tregues të Shërbimeve Publike të tjera



Analiza e shërbimeve

Shërbimi i rrjetit rrugor paraqet përmirësim të dukshëm në vitin aktual, sidomos në treguesin e përqindjes së rrjetit rrugor të shtruar, i cili është rritur nga 28.34% në 43.53%, (15% rritje) . Ky zhvillim tregon investime të konsiderueshme në infrastrukturën rrugore dhe rritje të aksesit për qytetarët. Shpenzimet për km të rrjetit rrugor janë rritur, duke reflektuar rritjen e kostove të investimeve dhe mirëmbajtjes.

Ndriçimi publik ka ruajtur të njëjtën gjatësi të rrjetit të mirëmbajtur prej 132.57 km, ndërkohë që numri i pikave funksionale të ndriçimit është rritur me 1.09%. Shpenzimet për ndriçimin publik janë rritur me 19.81%, çka lidhet me zgjerimin e shërbimit dhe rritjen e kostove operative. Në të kundërt, të ardhurat nga tarifa e ndriçimit kanë rënë me 16.02%, duke krijuar presion mbi financimin e sektorit.

Sipërfaqja e gjelbër publike për frymë ka mbetur pothuajse e pandryshuar në 5.16 m²/banor. Gjithashtu, niveli i mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbra ka mbetur konstant. Megjithatë, shpenzimet për m² gjelbërim publik kanë rënë me 41.96%, ndërsa numri i pemëve të mbjella është ulur me 5.83%. Kjo tregon reduktim të investimeve në sektorin e gjelbërimit.

Shërbimi i varrezave ka ruajtur 100% të mirëmbajtjes sipas planit, duke garantuar funksionim të qëndrueshëm. Megjithatë, kapaciteti i lirë i varrezave ka rënë nga 53.34% në 52.72%, duke treguar konsum gradual të hapësirave. Shpenzimet për varr aktiv kanë rënë me 28.86%, ndërsa të ardhurat nga tarifat janë ulur me 12.62%.

Shërbimi i kulturës ka shënuar një performancë pozitive. Numri i aktiviteteve kulturore për 1,000 banorë është rritur ,ndërsa pjesëmarrja në aktivitete është rritur me 24.74%. Shpenzimet për kulturë janë rritur ndjeshëm, ndërsa të ardhurat nga aktivitete kulturore janë rritur ,duke treguar zhvillim të sektorit kulturor.



Shërbimi sportiv ka shënuar rritje pozitive në aktivitetet sportive dhe pjesëmarrjen qytetare. Numri i pjesëmarrësve në aktivitete sportive është dyfishuar, me rritje prej 100%. Shpenzimet për sport dhe argëtim janë rritur me 23.98%, ndërsa sipërfaqja sportive publike për frymë ka mbetur e pandryshuar.

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Fusha	Sfida kryesore	Arritjet 2025	Objektivat 2026
-	<ul style="list-style-type: none"> - Mungesa e zgjerimit të sinjalistikës rrugore. - Kosto të larta të mirëmbajtjes për km. - Nevoja për përmirësim të cilësisë së rrugëve rurale. - Rënia e të ardhurave nga tarifa e ndriçimit. - Mbulim ende i kufizuar i sipërfaqeve publike me ndriçim. - Ulja e investimeve në gjelbërim. - Rënia e numrit të pemëve të mbjella. - Nivel i ulët i sipërfaqeve të gjelbra në zonat rurale krahasuar me standardet urbane. - Zvogëlim gradual i kapaciteteve të lira në varreza. - Rënie e të ardhurave nga tarifat. - Nevoja për zgjerim të kapaciteteve në të ardhmen të varrezave. - Shume pak e objekteve kulturore janë funksionale - Mungesë investimesh në infrastrukturë sportive. - Nevoja për rehabilitim të objekteve ekzistuese. 	<ul style="list-style-type: none"> - Ruajtje e plotë e mirëmbajtjes së rrjetit ekzistues. - Rritje e investimeve në infrastrukturën rrugore. - Mbulim i qëndrueshëm i territorit urban dhe rural me mirëmbajtje. - Rritje e numrit të pikave funksionale të ndriçimit. - Përmirësim i mbulimit të zonave urbane. - Përmirësim i gjelbërimit urban për frymë. - Vazhdimësi e mirëmbajtjes së hapësirave publike. - Mirëmbajtje e plotë e zonave të varrezave. - Rritje e madhe e aktiviteteve kulturore. - Rritje e pjesëmarrjes qytetare. - Aktivizim më i madh i jetës kulturore lokale. - Rritje e aktiviteteve sportive. - Dyfishim i pjesëmarrësve në aktivitete. - Rritje e mbështetjes financiare për sportin. 	<ul style="list-style-type: none"> - Rritja e përqindjes së rrugëve të asfaltuar rurale. - Zgjerimi i sinjalistikës dhe elementeve të sigurisë rrugore. - Rritja e eficiencës së shpenzimeve për mirëmbajtje. - Përmirësimi i aksesit në zonat rurale. - Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit në zonat periferike. - Investime në ndriçim eficient me teknologji LED. - Përmirësimi i arkëtimit të tarifave. - Rritja e mbulimit të hapësirave publike me ndriçim. - Rritja e sipërfaqeve të gjelbra publike rurale - Zgjerimi i gjelbërimit në zonat rurale. - Rikonstruksioni i objekteve kulturore. - Rritja e numrit të aktiviteteve gjatë gjithë vitit. - Nxitja e turizmit kulturor. - Mbështetje për artistët dhe grupet lokale. - Rikonstruksioni i objekteve sportive ekzistuese. - Zgjerimi i hapësirave sportive publike. - Rritja e aktiviteteve për të rinjtë. - Nxitja e sportit komunitar dhe aktiviteteve rekreative.



FUSHA E BIZNESIT

Sektori i bizneseve përbën një nga shtyllat kryesore të zhvillimit ekonomik vendor dhe ka ndikim të drejtpërdrejtë në punësim, investime, të ardhura vendore dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve. Gjatë periudhës së raportimit, Bashkia ka vijuar angazhimin për krijimin e një klime më mbështetëse për biznesin, duke synuar nxitjen e sipërmarrjes, formalizimin e aktiviteteve ekonomike, promovimin e investimeve dhe forcimin e bashkëpunimit me komunitetin e biznesit.

Analiza e treguesve të performancës në këtë sektor pasqyron nivelin e zhvillimit ekonomik në territor, dinamikën e regjistrimit të bizneseve të reja, mbështetjen ndaj ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si dhe shkallën e përfshirjes së tyre në programe zhvillimore dhe skema financimi. Gjithashtu, treguesit evidentojnë ndikimin e politikave vendore në krijimin e mundësive për investime, inovacion dhe rritje të konkurrueshmërisë së ekonomisë lokale.

Përmes monitorimit të këtyre treguesve, synohet të vlerësohet progresi i arritur në përmirësimin e klimës së biznesit, eficienta e shërbimeve të ofruara nga bashkia dhe niveli i bashkëpunimit institucional me aktorët ekonomikë. Raporti identifikon arritjet kryesore, sfidat ekzistuese dhe objektivat për periudhën në vijim, me fokus krijimin e një ekonomie lokale më të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe konkurruese.

TREGUESIT E PERFORMANCËS

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2024	Vlera 2025	Trendi	Trend Symbol	% Ndryshimi	Semafori
Tregues	Numri i bizneseve aktive	Numër	1903.00	1953.00	50.00	↑	0.03	●
Tregues	Numri i bizneseve të reja	Numër	127.00	243.00	116.00	↑	0.91	●
Tregues	Norma e krijimit të bizneseve	%	6.67	12.44	5.77	↑	0.86	●
Tregues	Norma e mbylljes së bizneseve	%	3.10	4.76	1.66	↑	0.54	●
Tregues	Pesha e bizneseve të drejtuara nga gra	%	24.54	24.88	0.34	↑	0.01	●
Tregues	Pesha e bizneseve / agro përpunuese & turizmit	%	8.15	8.04	-0.11	↓	-0.01	●



Tregues	Pesha e NVM-ve të asistuar nga bashkia	%	4.20	4.71	0.51	↑	0.12	●
Tregues	Numri i sesioneve të informimit/këshillimit për bizneset	Numër	15.00	15.00	0.00	→	0.00	●
Tregues	Numri i pjesëmarrësve në sesione dhe trajnime ekonomike	Numër	6510.00	8970.00	2460.00	↑	0.38	●
Tregues	Numri i startup-eve të mbështetura (grant/inkubim)	Numër	0.00	0.00	0.00	→	0.00	●
Tregues	Numri i investimeve të reja në territor	Numër	2.00	4.00	2.00	↑	1.00	●
Tregues	Vlera e investimeve të reja	Mijë lekë	46454.00	83866.00	37412.00	↑	0.81	●
Tregues	Numri i investimeve në zonat ekonomike	Numër	2.00	4.00	2.00	↑	1.00	●
Tregues	Numri i NVM-ve të integruara në zinxhirë vlere / konsorciume	Numër	7.00	7.00	0.00	→	0.00	●
Tregues	Numri i marrëveshjeve MoU bashki-biznes	Numër	74.00	81.00	7.00	↑	0.09	●
Tregues	Numri i turistëve të huaj	Numër	264492.00	287148.00	22656.00	↑	0.09	●
Tregues	Numri i vizitorëve ditorë	Numër	1047.00	1101.00	54.00	↑	0.05	●
Tregues	Netë-qëndrime në territor	Numër	135904.00	136083.00	179.00	↑	0.00	●
Tregues	Numri i strukturave akomoduese	Numër	40.00	41.00	1.00	↑	0.03	●
Tregues	Numri i shtretërve në struktura akomoduese	Numër	1760.00	1805.00	45.00	↑	0.03	●
Tregues	Turistë për shtretër (raport i ngarkesës)	turistë/shtretër	150.28	159.08	8.81	↑	0.06	●
Tregues	Numri i atraksioneve të inventarizuara	Numër	19.00	19.00	0.00	→	0.00	●



Tregues	Numri i operatorëve turistikë/guideve në territor	Numër	6.00	6.00	0.00	→	0.00	●
Tregues	Numri i qendrave të informacionit turistik (TIC)	Numër	1.00	1.00	0.00	→	0.00	●
Tregues	Numri i vizitorëve në qendrat TIC	Numër	5800.00	6100.00	300.00	↑	0.05	●
Tregues	Numri i eventeve kulturore/turistike	Numër	105.00	215.00	110.00	↑	1.05	●
Tregues	Numri i materialeve promovionale (broshura, fushata, web, etj.)	Numër	3600.00	1585.00	-2015.00	↓	-0.56	●

TË DHËNAT E SHËRBIMIT

Kodi i të dhënës	Kodi i Treguesit	Përdorur në treguesit	E dhëna	Vlera 2024	Vlera 2025	Njësia Matëse
EDB01	Numri i bizneseve aktive	IB01	Numri i bizneseve aktive në territor	1903	1953	Numër
EDB02	Numri i bizneseve të reja	IB02, IB03	Numri i bizneseve të reja të regjistruara (në vit)	127	243	Numër
EDB03	Norma e krijimit të bizneseve	IB18	Numri i bizneseve të mbyllura (në vit)	59	93	Numër
EDB04	Pesha e bizneseve të drejtuara nga gra	IB04	Numri i bizneseve të drejtuara nga gra	467	486	Numër
EDB05	Pesha e bizneseve / agro përpunuese & turizmit	IB05	Numri i bizneseve / agropërpunuese & turizmit	155	157	Numër
EDB06	Pesha e NVM-ve të asistuar nga bashkia	IB06	Numri i NVM-ve të asistuar nga bashkia (këshillim, shërbim)	80	92	Numër




EDB07	Numri i sesioneve të informimit/këshillimit për bizneset	IB07	Numri i sesioneve të informimit/këshillimit për biznes	15	15	Numër
EDB08	Numri i pjesëmarrësve në sesione dhe trajnime ekonomike	IB08	Numri i pjesëmarrësve në trajnime ekonomike	6510	8970	Numër
EDB09	Numri i startup-eve të mbështetura (grant/inkubim)	IB09	Numri i startup-eve të regjistruara në territor (aplikacion, platformë online, aplikacion finance online .Vetëm inovative)	4	5	Numër
EDB10	Pesha e startup-eve të mbështetura	IB09, IB10	Numri i startup-eve të mbështetura (grant, inkubim, mentorim)	0	0	Numër
EDB11	Pesha e NVM-ve të asistuar nga bashkia	IB06	Numri i aplikimeve të bizneseve në skemat kombëtare (AZHBR)	383	303	Numër
EDB12	Pesha e NVM-ve të asistuar nga bashkia	IB06	Numri i përfituesve të granteve/garancive në territor(AZHBR)	366	303	Numër
EDB13	Numri i investimeve të reja në territor	IB11	Numri i investimeve të reja të identifikuara në territor	2	4	Numër
EDB14	Vlera e investimeve të reja	IB12	Vlera e investimeve të reja	46454	83866	Mijë Lekë
EDB15	Numri i investimeve të reja në territor	IB11	Numri i investitorëve të asistuar (after-care)(që kanë marrë të paktën një shërbim mbështetës)	0	0	Numër
EDB16	Numri i investimeve në zonat ekonomike	IB13	Numri i lejeve të zhvillimit në zonat ekonomike	2	4	Numër
EDB17	Numri i marrëveshjeve MoU bashki-biznes	IB15	Numri i marrëveshjeve MoU të nënshkruara me biznese/org. biznesi(Numrin e marrëveshjeve të formalizuara për bashkëpunim ekonomik)	74	83	Numër



EDB18	Numri i NVM-ve të integruara në zinxhirë vlere / konsorciume	IB14	Numri i NVM-ve të përfshira në zinxhirë vlere (klasterë, konsorciume)(rrjete biznesesh që bashkëpunojnë për të krijuar një produkt ose shërbim)	7	7	Numër
EDTUR01	Numri i turistëve të huaj	ITUR01	Numri i turistëve të huaj (në qark/bashki)	264492	287148	Numër
EDTUR02	Numri i vizitorëve ditorë	ITUR02	Numri i vizitorëve ditorë	1047	1101	Numër
EDTUR03	Netë-qëndrime në territor	ITUR03	Numri i netë-qëndrimeve	135904	136083	Numër
EDTUR04	Numri i strukturave akomoduese	ITUR04	Numri i strukturave akomoduese (hotele, B&B, bujtina)	40	41	Numër
EDTUR05	Numri i shtretërve në struktura akomoduese	ITUR05	Numri i shtretërve në struktura akomoduese	1760	1805	Numër
EDTUR06	Turistë për shtretër (raport i ngarkesës)	ITUR06	ADR, RevPAR, norma e okupancës	77	75	Numër
EDTUR07	Numri i atraksioneve të inventarizuara	ITUR07	Numri i atraksioneve turistike të inventarizuara	19	19	Numër
EDTUR08	Numri i operatorëve turistikë/guideve në territor	ITUR08	Numri i operatorëve turistikë/guideve të licencuar në territor	6	6	Numër
EDTUR09	Numri i vizitorëve në qendrat TIC	ITUR09	Numri i qendrave të informacionit turistik (TIC)	1	1	Numër
EDTUR10	Numri i eventeve kulturore/turistike	ITUR10	Numri i vizitorëve në qendrat TIC	5800	6100	Numër
+EDTUR11	Numri i eventeve kulturore/turistike	ITUR11	Numri i eventeve kulturore/turistike në vit	105	215	Numër
EDTUR12	Numri i materialeve promociionale (broshura, fushata, web, etj.)	ITUR12	Numri i materialeve promociionale (broshura, faqe web, fushata)	3600	1585	Numër

Tregues për biznesin, kulturën, turizmin dhe investimet në zonat ekonomike



Analiza e shërbimit

Analiza e treguesve të performancës tregon një zhvillim pozitiv të sektorit të biznesit dhe turizmit në territorin e bashkisë gjatë vitit aktual. Numri i bizneseve aktive është rritur nga 1,903 në 1,953 biznese, duke reflektuar stabilitet ekonomik dhe zgjerim gradual të aktivitetit privat. Një tregues shumë pozitiv paraqitet në numrin e bizneseve të reja, i cili është rritur me 91%, nga 127 në 243 biznese të regjistruara, duke ndikuar drejtpërdrejt edhe në rritjen e normës së krijimit të bizneseve nga 6.67% në 12.44%. Edhe pse norma e mbylljes së bizneseve është rritur nga 3.10% në 4.76%, ritmi i hapjes së bizneseve të reja mbetet dukshëm më i lartë, çka tregon dinamizëm ekonomik në territor. Pësia e bizneseve të drejtuara nga gratë ka shënuar rritje të lehtë, duke arritur në 24.88%, gjë që tregon përfshirje më të madhe të grave në sipërmarrje. Në sektorin e mbështetjes së biznesit, pësia e NVM-ve të asistuara nga bashkia është rritur nga 4.20% në 4.71%, ndërsa numri i pjesëmarrësve në trajnime dhe sesione ekonomike është rritur ndjeshëm nga 4,510 në 8,970 pjesëmarrës. Kjo tregon rritje të ndërgjegjësimit dhe interesit të bizneseve për programe mbështetëse dhe zhvillimore. Megjithatë, sektori i startup-eve mbetet me një rritje të lehtë, por numri i startup-eve të mbështetura me grante apo inkubim rezulton zero, pavarësisht ekzistencës rritëse të startup-. Në aspektin e investimeve, numri i investimeve të reja është dyfishuar nga 2 në 4 investime, ndërsa vlera e investimeve është rritur me 81%, duke arritur në 83,866 mijë lekë. Po ashtu,



numri i marrëveshjeve MoU ndërmjet bashkisë dhe biznesit është rritur në 83 marrëveshje, duke treguar forcim të bashkëpunimit institucional. Sektori i turizmit paraqet performancë pozitive. Numri i turistëve të huaj është rritur në 287,148 vizitorë, ndërsa numri i eventeve kulturore dhe turistike është dyfishuar nga 105 në 215 aktivitete. Është rritur gjithashtu numri i strukturave akomoduese dhe kapaciteti i shtretërve, duke reflektuar zgjerim të ofertës turistike në territor. Nga ana tjetër, numri i materialeve promovionale ka pësuar rënie të ndjeshme nga 3,600 në 1,585 materiale, duke evidentuar nevojën për forcim të promovimit turistik dhe marketingut territorial.

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Fusha	Sfida kryesore	Arritjet 2025	Objektivat 2026
Fusha e biznesit	<ul style="list-style-type: none"> -Rritja e normës së mbylljes së bizneseve. - Mungesa e mbështetjes direkte për startup-et dhe bizneset inovative. - Numër i kufizuar i operatorëve turistikë dhe qendrave TIC. - Rënie e materialeve promovionale dhe aktiviteteve të marketingut territorial. - Nivel ende i ulët i integritimit të NVM-ve në zinxhirë vlere dhe konsorciume. - Nevoja për më shumë investime në sektorin agro-përpunues dhe turizëm. - Kapacitete të kufizuara për mbështetje financiare dhe inkubim biznesi. 	<ul style="list-style-type: none"> - Rritje e numrit të bizneseve aktive dhe bizneseve të reja në territor. - Rritje e investimeve të reja dhe e vlerës së tyre financiare. -Forcim i bashkëpunimit bashki-biznes përmes rritjes së marrëveshjeve MoU. - Rritje e pjesëmarrjes në trajnime dhe sesione ekonomike. - Rritje e numrit të turistëve të huaj dhe eventeve turistike. - Zgjerim i kapaciteteve akomoduese dhe rritje e ofertës turistike. - Rritje e përfshirjes së grave në drejtimin e bizneseve. 	<ul style="list-style-type: none"> - Rritja e numrit të bizneseve të reja dhe ulja e normës së mbylljes së tyre. - Krijimi i programeve mbështetëse për startup-e dhe inovacion. - Zgjerimi i asistencës për NVM-të dhe aplikimet në skema kombëtare financimi. - Rritja e investimeve private dhe promovimi i zonave ekonomike. - Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet bashkisë dhe komunitetit të biznesit. - Zhvillimi i sektorit agro-përpunues dhe turizmit lokal. - Rritja e promovimit turistik përmes materialeve digjitale dhe fushatave marketingu. - Rritja e integritimit të bizneseve lokale në klasterë dhe zinxhirë vlere ekonomike.